

Permbledhje Joteknike e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis Aktiviteti : “Impiant thyerje -fraksionim i materialeve inerte impiant prodhim betoni dhe impiant prodhimi asfalto-betoni”



Vendodhja e ushtrimit te aktivitetit : Cërrave, Pogradec

SUBJEKTI : “2T” shpk

PROJEKTUES : “STUDIO PROJEKT“ shpk

Tirane 2016

PERMBAJTJA

1-HYRJE

- 1.1 Legjislacioni Mjedisor ne Shqiperi
- 1.2 Metodika e pergatitjes se studimit te VNM
- 1.3 Pershkrim te qellimit dhe objektivave te VNM

2- PERSHKRIMI I PROJEKTIT

- 2.1 Qellimi i zhvillimit te projektit
- 2.2 Alternativa e analizuar
- 2.3 Vendodhja e projektit

3- PERSHKRIMI TEKNIK I PROJEKTIT TE IMPIANTIT TE THYERJE- FRAKSIONIMIT ,IMPIANTITI TE PRODHIMIT TE BETONIT DEH ASFALTO-BETONIT

- 3.1 Pershkrimi i skemes teknologjike te impiantit te thyerje fraksionimit
- 3.2 Pershkrimi i skemes teknologjike te impiantiti te prodhimit te betonit
- 3.3 Pershkrimi i skemes teknologjike te impiantiti te asfalto-betonit

4- PERSHKRIMI I VENDIT DHE MJEDISIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

- 4.1 Pershkrim te karakteristikave fizike te zones se projektit
- 4.2 Pershkrim i biodiversitetit ne zonen e projektit
- 4.3 Pershkrim i cilesise se mjedisit dhe ndikimeve ekzistuese
- 4.4 Pershkrim i karakteristikave sociale te zones ku propozohet projekti

5- VLERESIMI I NDIKIMEVE

- Metoda e zbatuar per parashikimin e ndikimeve ne mjedis
- Shtrirja fizike dhe kohezgjatja e ndikimeve te identifikuara (Shkalla)

- 5.1 Ndikimet e mundshme ne shendetin e njerezve
- 5.2 Nivelet dhe ndikimet e zhurmave
- 5.3 Ndikimet ne rruge lokale dhe transport
- 5.4 Ndikimet ne flore dhe faune

- 5.5 Ndikimet ne toke
- 5.6 Ndikimet ne uje
- 5.7 Ndikimet ne ajer
- 5.8 Ndikimet ne klime
- 5.9 Ndikimet ne ekonomi
- 5.10 Ndikimet mbi trashegimine kulturore
- 5.11 Ndikimet me natyre nderkufitare

6- MASAT PER ELEMENIMIN/ ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE

- 6.1Masat ndaj erozionit
- 6.2Masat per emetimet ne ajer
- 6.3Masat per uljen ne minimum te zhurmave
- 6.4Masat per Shkarkimet ne uje
- 6.5Masat per Depozitimet ne toke
- 6.6Masat estetike dhe ekologjike
- 6.7Masat rehabilituese, në rast ndotje dhe dëmtimi të mjedisit
- 6.8Masat ndaj zjarrit
- 6.9Vlerësimi i efektivitetit të pritsëm të masave zbatuese

7- PROGRAMI I MONITORIMIT TE NDIKIMIT TE PROJEKTIT NE MJEDIS

8- PLANI I MENAXHIMIT TE MBETJEVE

9- KONKLUZIONE

1-HYRJE

Subjekti “2T” shpk është regjistruar pranë Qendres Kombetare të Biznesit me numer NIPT K01731001M me datë 31/05/2000 me seli Tirane Tirane TIRANE Rruga Asim Vokshi, Nd. 14, H. 4, Ap. 5 dhe administrator Artan Sako, me aktivitetet Në fushën e ndertimit, projektimit, ndertime civile dhe industriale, ndertim rrugë dhe kanalizime etj.

Shoqëria “**Rawafed AL-Torok Ndërmarrje Kontraktuese-Dega e Shqipërisë**” Degë e **Shoqërisë së Huaj** ka fituar të drejtën për ndertimin e rrugës Qukes-Qafe Plloce, Km.33+800 - Km.43+310 (loti 3, Bashkia Pogradec, Qarku Korçë). **Shoqëria 2T shpk është nenkontraktore e kësaj shoqërie për ndertimin e rrugës.**

Mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk është i rëndësishëm vetëm për njëzëzit por është thelbësor dhe i nevojshëm për të gjitha qeniet në tokë. Njëzëzit duhet të kuptojnë se si përdorimi i burimeve mjedisore dhe përfitimet që vijnë nga ato të mos demtohen por të jete e mundur të përfitohet sot dhe në të ardhmen.

Ndotja e mjedisit nënkupton shkakimet e cdo lloj mbetje nga pjesë të materialeve të ndryshme në ujë, tokë, ajër e cila shkakton ose mund të shkaktojë probleme mjedisore të perkoheshme ose të përhershme në balancën ekologjike të tokës. Sebasku me zhvillimin e madh që është bërë në industri të ndryshme në mënyrë të ngjashme me të njëjtën shpejtësi është rritur edhe sasia e mbetjeve nga përdorimi i të mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane të patrajtuara, emetimet e gazeve të demshëm në atmosferë, përdorimi i kimikateve të reja pa marrë parasysh demet që mund të sjellin mjedisit kanë sjelle problemet mjedisore me të cilat në përballemi në ditët e sotme.

Ndaj është e nevojshme që shoqëria të ndergjegjësohet për ta mbajtur sa më pastër mjedisin ku jetojmë duke marrë masat e duhura për trajtimin e mbetjeve si dhe emetimin e gazeve të demshëm në atmosferë që gjenerohen nga zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme.

Në mënyrë që të shmangen këto probleme njëzëzimi duhet të mesojë se si të menaxhohen burimet natyrore në mënyrë të qëndrueshme. Për zhvillimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore nuk është gje tjetër veçse përdorimi i tyre në mënyrë ekonomike nga brezat e sotëm për të lënë këto burime të përdoren edhe nga brezat që do të vijnë.

Qëndrueshmëria përfshin menaxhimin e gjithë perberësve dhe burimeve natyrore e njëzëzore me qëllim që të pasurohen me kalimin e kohës dhe të sigurohet një mirëqenie për të gjithë. Zhvillimi i qëndrueshëm nuk i pranon politikatat të cilat çojnë në uljen e bazës prodhuese dhe lënë gjeneratat

e ardhshme me prespektiva me te ulta (te varfëra) dhe/ose rreziqe me te medha se te tonat. Teknologjite qe kontribuojne ne zhvillimin e qendrushem perfshijne kontrollin e ndotjes, prodhimin e energjise se riciklueshme, rikuperim burimesh dhe riciklim, menaxhim burimesh dhe kerkime shkencore.

Aktiviteti te cilin ne do te trajtojme eshte ”**Impiant thyerje- fraksionimi inertesh, impiant Prodhim Betoni dhe impiant prodhim asfalto-betoni**” i vijne ne ndihem shoqerise per ndertimin e rruges Qukes-Qafe Plloce, Km.33+800 - Km.43+310 (loti 3, Bashkia Pogradec, Qarku Korçë).

1.2 Legjislacioni Mjedisor ne Shqiperi

Ne Shqiperi fillesat e legjislacionit mjedisor shfaqen ne vitin 1993 , vit ne te cilin u hartua plani i pare i veprimit ne fushen mjedisore, qe perben dokumentin e pare zyrtar shqiptar mbi politikat mjedisore ne vend. Ky plan veprimi kombetar parashikonte se qeveria duhet te krijojë kuadrin ligjor , ekonomik dhe institucional per zgjidhjen e ceshtjeve mjedisore. Periudhen nga ky vit deri ne miratimin e Kushtetutes ne vitin 1998 mund ta konsiderojme si etapen e pare te zhvillimit te se drejtes shqiptare te mjedisit. Mbas vitit 1998 e ne vijim eshte periudha e dyte e zhvillimit te se drejtes shqiptare te mjedisit, e cila ka si tipar kryesor prirjen e perafimit me legjislacionin e Bashkimit Europian per mjedisin. Kuadri ligjor mjedisor shqiptar eshte ne persosje dhe pasurim te vazhdueshem dhe zhvillimi i tij nuk i eshte len rasteies, por ka si model dhe drejtues legjislacionin europian te mjedisit. Duke qen se kushtetutat ravigezojne drejtimet e rregullimeve te ardhshme dhe me te hollesishme qe realizohen fillimisht me ligje dhe me pas me akte nenligjore edhe ne rastin e vendit tone Kushtetuta perben nje fillese dhe baze te rendesishme lidhur me rolin qe ka mjedisi per shoqerine dhe shtetit tone. Nisur nga permbajtja e neneve te Kushtetutes lidhur me fushen mjedisore mund te pohojme se fryma e Kushtetutes sone eshte ne perputhje me ate te shume kushtetutave te vendeve te tjera demokratike qe u kushtojne rendesi te nje niveli me te larte disa parimeve mjedisore, duke i ngritur ato ne nivelin e ligjit themelor te shtetit, sic jane e drejta per informimin e qytetareve dhe angazhimi e pergjegjesia per nje mjedis te pershtatshem per te jetuar jo vetem brezat e sotem por edhe ata ne te ardhmen.

-VKM nr.686 date 29.7.2015 « Per miratimin e rregullave , te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit e Deklarates Mjedisorë »

- Ligj nr 12/2015 per disa ndryshime ne ligjin nr. 10440 date 07.07.2011 « Per vleresimin e ndikimit ne mjedis »

- VKM nr. 575 date 24.06.2015 Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte
- VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shyrtingin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja.
 - VKM. Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”
 - VKM. nr. 13 date 4.1.2013 « Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis »
 - Ligji Nr.10 431,date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”
 - Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”
 - Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »
 - Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »
 - Ligj Nr 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”.
 - Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »
 - Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’
 - Urdhri e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”
 - Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”
 - VKM. Nr 177, datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngta dhe kriteret e zonimit të mjedisëve ujore pritëse”.
 - Ligji Nr 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.
 - Ligji Nr 9115, datë 27.02.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujrave të ndotur”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.
 - Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”
 - Ligji Nr 8906, datë 06.02.2002 “Për zonat e mbrojtura”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.
 - Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”
 - Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave

1.3 Metodika e Studimit te VNM-se

Vleresimi i ndikimit ne mjedis eshte nje proces qe siguron qe ndikime mjedisore te rendesishme, sinjifikante jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim, zbatim te aktivitetit qe do te zhvillohet.

Ndikimi – efekti i zhvillimit te aktivitetit ne mjedis

Vleresimi – analiza qe i behet aktivitetit per evidentimin e ndikimeve negative dhe pozitive

Mjedisi – elementet abiotike (kushtet fiziko- kimike te mjedisit) te kombinuara me elementet biotike (qeniet e gjalle te mjedisit).

Mjedisi fizik perbehet nga :

- qeniet e gjalla (flora , fauna)
- pjesa jo e gjalle (toke, ajer, uje)
- peizazhe (ndikimi vizuale)
- pasurit materiale
- pasuri kulturore (interes historik, turizem)

Mjedisi shoqeror ndahet ne :

- personal
- nderpersonal
- institucional (shendet, ekonomi, etj)

Per te ber nje vleresim sa me te sakte te ndikimeve ne mjedis nga zhvillimi i aktivitetit Studimi i vleresimit te ndikimit ne mjedis u orientua nga rendesia dhe madhesia e projektit, vendi ku ai ndodhet, pasurite natyrore dhe humane te zones si dhe vlerat e veçanta te tyre ne indentifikimin e ndikimeve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutese per eleminimin, zvogelimin e ndikimeve duke patur parasysh edhe ruajtjen e interesave ekonomike te investitorit.

Studimi strukturohet ne kater faza kryesore :

1.Ngritja e objektivave orientuese te V.N.M.

2.Shqyrtimi i materialeve teknike

3.Verifikimi ne terren i te dhenave ekzistuese dhe mbledhja e te dhenave te

mundshme biofizike dhe humane.

4.Hartimi i raportit te vleresimit te ndikimet ne mjedis sipas legjislacionit mjedisor

Ky studim ka per qellim te jap konsideratat mjedisore te projektit te propozuar ne menyre qe te orientoje institucionet dhe organet vendim marrese ne dhenien e miratimin e lejes se kryerjes te aktivitetit.

Per te arritur nje vleresim sa me real te territorit duhet te analizojme situaten duke evidentuar pikat kyce si:

- Legjislacioni mjedisor
- Madhesia e projektit

- Pozicioni gjeografik ku do te zhvillohet
- Ndikimet e mundshme ne mjedis si pasoje e zhvillimit te aktivitetit
- Te dhenat gjeologjike te zones
- Te dhenat mbi floren dhe faunen e zones
- Popullsia , gjendja ekzistuese dhe e ndryshimeve

1.4 Perskrim te qellimit dhe objektivave te VNM

Vleresimi i ndikimit ne mjedis eshte nje proces ne vazhdimesi i aktivitetit dhe siguron se ndikimet mjedisore te rendesishme, sinjifikante jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim, zbatim te aktivitetit qe do te zhvillohet.

Qellimi i VNM- se

Qellimi i hartimit te raportit te VNM-se eshte percaktimi i efekteve negative dhe pozitive te aktivitetit dhe masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis si rezultat i zhvillimit te projektit.

VNM nuk do te mbuloj cdo aspekt te nje efekti mjedisor te projektit, me te njejtin nivel detajesh. Theksi do te vihet ne ndikimet kryesore qe shkakton zhvillimi i aktivitetit.

Gjithashtu nje synim tjeter eshte te percaktoje e rekomandoje masat teknike- organizative per zbutjen e aneve negative qe mund te krijohen gjate zhvillimit te aktivitetit dhe te jape informacion per vendim-marresit per pasojat mjedisore te aktiviteteve te propozuara.

VNM perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrushmerise se mjedisit nepermjet :

- Marrjes ne konsiderate te ndikimeve te mjedisit qe ne fazen e pergatitjes se propozimeve ne projekt.
- Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
- Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit ne mjedis te aktivitetit
- Analizes se faktoreve pozitive e negative mjedisore dhe te masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative.
- Nxjerrjes ne dukje dhe vleresimi cilesor me pika te ndikimeve ne mjedis te projektit.
- Propozime te masave zbutese te ndikimit ne mjedis te projektit.

Objektivat e VNM

Objektivat e hartimit te VNM- se konsistojne ne evidentimin dhe reduktimin e ndikimeve ne mjedis dhe masat tekniko-organizative per nje zhvillim te qendrushem te mjedisit, gjate

kryerjes se aktivitetit deri ne perfundim te aktivitetit dhe rehabilitimin e hapësirës te prekur nga aktiviteti, per nje mjedis te qendrueshem ne vitet pas ardhese.

Me kete studim informojme organet vendim-marres, mbi ndikimet ne mjedis dhe perfitimet e projektit te propozuar. Gjithashtu zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe zbatimi i projektit nuk prek burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose veprimtari.

Objektivat e tjera te studimit te paraqitur jane.

- Permiresimet mjedisore te zones ku zbatohet projekti dhe rreth saj.
- Perdorimin e burimeve natyrore ne menyren te qendrueshme ku respektohen dhe kerkesat e komunitetit te zones per rreth.
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale negative te projektit te zbatuar
- Lehteson informimin e organeve vendim-marrese, duke perfshire vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit apo propozimit.
- Mbrojtjen e shendetit te njeriut.
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit.
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, peizazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve.
- Permireson aspektet sociale te projektit.

2- PERSHKRIMI I PROJEKTIT

2.1 Qellimi i zhvillimit te projektit

Qellimi i ketij aktiviteti eshte fraksionimi i materialeve inerte ,prodhimi i betonit dhe asfalto betonit per ndertimin e rruges Qukes-Qaf Plloce. Per te realizuar kete aktivitet shoqeria do te ndertoj impiante me teknologji bashkekohore. Lenda e pare sigurohet nga karriera ne afersi. Te gjitha proceset e punes qe nga sigurimi i lendeve te para materialeve inerte e deri ne prodhimin e produktit perfundimtar qe eshte betoni dhe asfalto betoni do te zbatohen konform akteve ligjore ne fuqi per mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qendrueshem te tij. Pra me kete vleresim mjedisor japim informacion per projektin qe do te realizohet, vleresimin e ndikimeve negative dhe pozitive ne mjedis, si dhe masat qe do te merren nga investitori per zbatimin e kriterave per mbrojtjen e menaxhimin e qendrueshem te mjedisit. Procesi teknologjik i prodhimit te inerteve te fraksionuara dhe betonit ne linjat perkatese eshte me cikël te mbyllur dhe ky aktivitet nuk cliron ne ambient gaze, pluhura dhe lengje te demshme per shendetin e njerezve.

2.2 Alternativa e analizuar

Perzgjedhja e kesaj zone ka ardhur si rrjedhoje e perfshirjes se kesaj zone ne afersi te karrieres qe kerkon te shfrytëzohet shoqeria per zbatimin e projektit te ndertimit te rruges.Zonimi funksional

percakton qarte sistemin rrugor qe lidh zonen me rruget ekzistuese. Trualli ne fjale do te plotesohet me te gjitha ndertimet e nevojshme per nje objekt konform kushteve teknike ku nuk do te mungojne parkimi, rruge te brendshme si dhe ndarja nga rruga kryesore me breza te gjelberuar.

2.3 Vendodhja e projektit

Aktiviteti do te zhvillohet ne fshatin Çërravë, Pogradec. Perfshihet ne Njesine Administrative Çërravë dhe gjendet ne krah te rruges automobilistike Çërravë-Peshkëpi.



“2T”shpk



PERSHKRIMI INSTALIMEVE QE BEJNE PJESE NE PROJEKT DHE QE PERDOREN GJATE ZBATIMIT TE TIJ

Krahas ndertimit te linjes teknologjike per prodhimin e inerteve me thyerje fraksionim dhe impjantit te prodhimit te betonit , ne kete objekt do te behen instalime qe bejne pjese ne projekt dhe jane te domosdoshme per kete aktivitet, si:

- Instalimet e furnizimit me energji elektrike.
- Instalimet e mbrojtjes nga zjarri dhe sistemi hidranteve.
- Sistemi mbrojtjes nga shkarkesat atmosferike.
- Instalimet e ujit per perdorim vetiak, sheshet te punes te impjantit te prodhimit te inerteve dhe betonit, e asfalto betonit.
- Sistemi vaskave te dekantimit se llumrave nga aktiviteti.

PERSHKRIMI I VEPRAVE INXHINERIKE QE NDERTOHEN NE SHERBIM TE IMPIANTIT TE THYERJE- FRAKSIONIMIT TE INERTEVE SI DHE IMPIANTIT TE PRODHIMIT TE BETONIT IDUSTRIAL

Objekti prodhimit te inerteve me impjant me thyerje fraksionim dhe impianti i prodhimit te betonit , asfalto betonit jane objekte industriale me investime minimale dhe nuk perben veper inxhinierike.

Pavaresisht sa me siper per te realizuar prodhimin e projektuar ne kete objekt do te behen investime si:

- a- Rrethimi objektit
- b- Vaskat e dekantimit
- c- Ndricimi
- d- Tokezimi

Rrethimi objektit


Rrethimi perfshin gjithë siperfaqen e linjes se thyerje-fraksionimit si dhe linjes se prodhimit te betonit e asfalto betonit dhe ka per qellim te ndaloje komunikimin e njerzve qe nuk kane lidhje pune dhe hyrjen e kafsheve ne territorin e tij.

Rrethimi do te behet me rrjete metalike me lartesi 1m dhe mbi te deri ne lartesine 2m me tela me gjemba, me largesi midis shtyllave 2m.

Vaskat e dekantimit

Ujerat e ndotura nga pluhurat e krijuara do te depozitohen ne vaskat e ndertuara ne sheshin ne afersi te impianteve ne nivelet me te ulta te saj.

Praktikisht do te ndertohen dy vaska me keto parametra: gjatesi 6 m, gjeresi 3 m dhe thellesi 2 m. Uji i ndotur do te shkarkohet ne nje vaske dhe pasi te dekantohet , ujerat kalojne ne vasken tjeter. Ujrat largohen nga vaska pasi te jene ngurtesuar masa e ngurte inerte dhe depozitohen ne sheshin e caktuar nga pushteti vendor ose ne sheshin ne nje zone te percaktuar . Vaskat rrethohen me lartesi deri 2 m me rrjet metalike te qendrueshme per tu mbrojtur nga renia e njerezve ne to dhe per te menjanuar aksidentet ne pune. Ujerat e pastra pas vaskave do te riperdoren per lagien e territorit per eleminim e pluhurave.



Ndricimi objektit

Ndricimi objektit behet nga rrjeti elektrik.

Ndricimi eshte projektuar te jete modern sa me afer ndricimit diellor dhe te jete dekorativ.

Ndricimi i territorit te objektit, rrugelimit te makinave, te njerezve, sheshit te depozitave, rrethimit, etj, do te behet me projektore te vendosura ne shtylla metalike me lartesi 8-10m

Ndersa ndricimi vendeve te punes se punonjesve ne sheshin e linjes, bunkerin e shkarkimit te makinave, panelin e komandimit do te behet me ndricues neoni. Paisjet e ndricimit si llampat, celsat, leshuesit etj jane te tipit normal.

Ndersa kabllot elektrik te futura ne tuba celiku. Keto masa merren me qellim qe po te ndodhin lidhje te shkurtra ne percjellesat, ndricuesit, celsat, leshuesit, elektromotoret etj te mos kete kontakt me ambjentin e jashtem. Tipi elektromotoreve, ndricueseve, celsave, kablllove dhe paisjeve te tjera elektrike jepen ne projektin e zbatimit.

Tokezimi

Te gjitha paisjet do te jane te tokezuara. Rezistenca e tokezimit nuk duhet te jete me e madhe se 5 om. Tokezimi mbron njerzit nga renia ne tension, paisjet nga rrymat rrjedhese, ngarkesat statike dhe shkarkimet elektrike.

3- PERSHKRIMI I PROJEKTIT TE IMPIANTIT TE THYERJE FRAKSIONIMIT DHE IMPIANTIT TE PRODHIMIT TE BETONIT DHE ASFALTO-BETONIT

Sheshi ku do te instalohen linjat do të lidhet me rrugë dytësore nga rruga automobilistike . Lenda e pare qe do te perdoret per prodhim betoni deh asfalto-betoni eshte material inert shfrytezuar nga karriera ne afersi dhe qe fraksionohet ne impiantin e thyerje fraksionimit.

Objektivat e investitorit jane:

- Prodhim inerte si: rere suvatimi dhe rere betoni, granile, cakull, etj per prodhim betoni industrial dhe asfalto betonit per perdorim ne ndertimin e rruges.
- Zbatimin e nje teknologjie te re te perparuar ne prodhimin e inerteve nga thyerja dhe fraksionimi , me dimensione sipas kerkesave teknologjike.
- Kualifikimin e metejshe me te punonjesve.

3.1 PERSHKRIMI SKEMES TEKNOLOGJIKE TE IMPIANTIT TE THYERJE FRAKSIONIMIT

Qellimi i projektit

Qellimi i projektit eshte ndertimi impjantit te thyerje fraksionimit te inerteve te shfrytezuara ne karriera ne afersi per prodhimin te lendeve te para si, rere suvatimi, rere betoni, granil “1”, granil “2”, cakull, etj dhe prodhimin te betonit industrial dhe asfalto betonit per ndertimin e rruges. Procesi teknologjik do te kryhet sipas skemes klasike te prodhimin te inerteve me baze materiali gur gelqeror.

Impjanti thyerje fraksionimit te materialit te shfrytezuar perbehet nga keto linja kryesore:

- Bunkeri i pranimit te inerteve
- Sistemi i shtyrjes se inerteve me parimin e biell-manivel
- Transportier nepermjet te cilit inertet kalojne nga bunkeri ne franto

- Frantoja me cekica horizontal te vendosur ne aks per thyerjen e inerteve
Me hapesire te hyrjes 1.2*0.8 m dhe me madhesi te agregatit deri ne 0.6 m dhe pas copetimit shkon 0-120 mm.
- Nje pajisje ushqyese me vibrim elektromekanik per frantone
- Transportier Lenda inerte e thyer ne copa me te vogla nepermjet ketij transportieri kalon nga frantoja ne lavatriçen rrotulluese ku behet larja me uje te rrjedhshem
- Sita Vibruese me larje me 3 tipe sitash koaksiale për dimensione të ndryshme të lendes inerte
- Bunker i vogel me shnek qe mbledh fraksionin e 0-5 mm te reres dhe ushqen transportierin e ketij fraksioni
- Rera e imet 0.5 mm kalon nga bunkeri me shnek ne nje lavatriçe tjetër te veçante vetem per reren e cila ka kerkesa me te larta teknologjike
- Transportier Fraksioni 0.5 mm i reres nepermjet ketij transportieri kalon nga lavatriçja e reres dhe dergohet në sheshin e hapur të depozitimit të produktit të gatshem
- Dy transportiera, Fraksionet 5-12 dhe 12-24 mm i reres nepermjet ketij transportieri kalon nga sita vibruese në sheshin e hapur të depozitimit të produktit të gatshem.

- Transportier Fraksioni i trashe i inerteve mbi 24 mm nepermjet ketij transportieri rikthehet nga sita vibruese qe del si mbetje dhe dergohet në bunkerin e mullirit (silos) me synimin për ta bluar dhe rikthyer perseri në site.
- Silos qe grumbullon materialin inert mbi 24 mm të rikthyer nga sita me synim për ta bluar ne mullirin me çekiça,
- Mulliri me çekiç sherben per te thyer kokrrizat me te medha se 24mm te inerteve qe rikthehen nga sita nepermjet transportierit me shirit
- Transportir Materiali inert i thyer qe del nga mulliri nepermjet ketij transportieri kthehet perseri ne sistemin e prodhimit ne pozicionin per ta rikthyer perseri në site.

Lenda e pare, nga sheshi ku depozitohet futet nga piacala ne bunkerin 1. me ane te transportierit 2 ajo kalon nje frantone 3 ku behet thyerja e copave te medha te gurit mbi 24 mm. Nga frantoja kalon me transportier ne lavatriçen horizontale rrotulluese 4 ne te cilen behet larja e baltes (dhera e argjila) me uje te rrjedhshem. Pastaj nepermjet sitave rrotulluese koaksiale 5 behet ndarja ne fraksione e reres dhe e granileve. Fraksioni i trashe rikthehet perseri me nje transportier tjetër ne bunkerin 6 te mullirit me çekiça 7. Ne mullirin me çekiç behet bluarja e copave te inerteve (gureve) me te medha se 24 mm dhe me te vogel se materiali qe hyn ne franto. Nga mulliri me çekiç materiali i punuar kalon perseri ne sistemin e sitave per fraksionim. Rera e imet 0.5 mm kalon perseri per larje ne lavatriçen e reres. Larja e reres eshte kerkese teknologjike e materialeve inerte te cilesise se larte.

Kapaciteti i prodhimit te impiantit te fraksionimit 70-85 m³/ore.

3.2 PERSHKRIMI I SKEMES TEKNOLOGJIKE TE IMPIANTIT TE PRODHIMIT TE BETONIT INDUSTRIAL

Lendet e para te projektuara per prodhim betoni ne impiant

Lendet e pare qe do te perdoret per prodhim betoni do te jene inerte te dala nga impianti I fraksionimit.

Inertet qe do perdoren per prodhim betoni do te jene te emertuara dhe me madhesi copash si vijon:

Rere betoni me madhesi copash	0mm – 5mm
Granil “1” me madhesi copash	5mm – 12mm
Granil “2” me madhesi copash	12mm – 30mm

Per prodhimin e betonit bashke me inertet do te shtohet filer, uji, cemento dhe aditiv.

ELEMENTET DHE AGREGATET QE PERBEJNE LINJEN E PRODHIMIT TE BETONIT

- a- Sheshi i depozitimit te inerteve.
- b- Bunkeret e inerteve.
- c- Transportieret e inerteve.
- d- Silloset e cementos.
- e- Shneket e cementos.
- f- Peshorja e inerteve.
- g- Peshorja e cementos.
- h- Distributori per percaktimin e sasise se ujit qe hidhet ne betoniere.
- i- Perzieresi
- j- Pulti i komandes dhe kontrollit te parametrave te projektuar per prodhim betoni.

Sheshi i depozitimit te inerteve

Sheshi i depozitimit te inerteve do te ndertohet sipas projektit ne kuoten e bunkereve te favorizuar nga relievi. Ne nyje te ndryshme sipas kushteve konkrete ky shesh mund te jete ne formen e nje rampe.

Sheshi do jete i betonuar qe te mos ndoten inertet qe depozitohen. Sheshi eshte projektuar qe te ndertohet ne planin horizontal ne kuoten e nivelit te siperm te bunkereve.

Sheshi sherben per shkarkimin direkt te makinave te inerteve ne bunkeret perkates dhe per te depozituar rezervat e inerteve per disa dite pune, qe te mos pengohet prodhimi betonit ne rastet kur nuk sigurohet lenda e pare nga nyja e inerteve ne raste difektesh te tyre.

Inertet e depozituara ne shesh, ne kuoten e siperm te bunkereve, hidhen me fadrome sipas fraksionit ne ndarjet perkates te bunkerit. Ne keto kushte siperfaqja e sheshit duhet te kete madhesi te mjaftueshem per rezerven e duhur ne rere betoni, granil 1, granil 2. dhe fadroma te levize lirshem ne territorin e bunkereve.

Inertet e depozituara ne shesh hidhen ne bunker me fadrome sipas receptures se percaktuar nga teknologu.

Nga ana e vendosjes se bunkerit sheshi i depozitimit te inerteve eshte vertikal me mur mbajtes betoni me armim hekuri, me diameter 18mm , me trashesi betoni ne baze 1.2m dhe gjeresi ne pjesen e siperm 0.6m.

Bunkeri pranimit te inerteve

Bunkeri i inerteve eshte konstruksion metalik dhe ndertohet me llamarine me trashesi 10mm, te sallduara dhe te perforcuara ne profile hekuri ne forme “L”, me 4 ndarje ku do te depozitohen respektivisht inertet me dimensionet si me poshte:

Rere me dimension	0-4 mm
Rere me dimension	0-5 mm
Granil “1” me dimension	5-12 mm
Granil “2” me dimension	12-30 mm

Bunkeri prej llamarin, vendoset mbi bazament, kollona betoni 650mm x 650mm me peshe mbajtese 250 ton, mbi te cilat mbeshteten pllaka metalike me dimensione 500mm x 500mm dhe trashesi 15mm.

Bunkeri do te kete kater ndarje me vete per hedhjen e inerteve sipas fraksioneve 0-4 mm, 0-5mm, 5-12mm, 12-30mm, qe do te shkarkohen ne trasportier nepermjet hinkave te komanduara nga pulti i leshimit ne peshen e percaktar ne projekt per marken perkatese te betonit dhe te miratuar nga teknologu i impjantit.

Inertet qe do te perdoren per pergatitjen e betonit, sipas markes se kerkuar dhe recepturave, ne sasi te reres se betonit, granilit “1” granilit “2”, cementos dhe ujit realizohen nepermjet komandes se dhene nga drejtuesi ne pult,ku automatikisht me tu arritur pesha e kerkuar peshorja elektronike automatikisht mbylli grykat e bunkereve dhe nepermjet trasportjerit inertet dergohen ne betoniere.

Transportieret e inerteve

Linja perbehet nga tre trasportiere.

Nen hinkat e bunkerit montohen dy trasportiere me drejtim levizje te kundert qe sherbejne per te trasportuar inertet qe shkarkohen mbi ta ne trasportierin kryesor qe e dergon materialin ne perzieres dhe prej aty ne makinin betoniere.

Transportieret montohen horizontalisht mbi konstruksione metalike, me gjeresi te shiritit te gomes 1.2m.

Keto vihen ne levizje me ane te dy elektromotoreve.

Ndersa trasportieri i trete sherben per te derguar inertet ne makinen bunker dhe furnizohet nga trasportieret e montuar nen hinkat e bunkerit.

Ky trasportier vendoset mbi konstruksion metalik ne plan te pjerret.

Lartesia e tamburos aktive nga toka ne pjesen e poshtme te saj duhet te jete mbi 3.6m qe eshte e kondicionuar nga lartesia e betonieres.

Transportieret perbehen nga konstruksione metalike. Ne keto konstruksione montohen tamburot aktive, reduktoret me elektromotoret perkates, tamburot pasive dhe rulot mbi te cilat mbeshetet rripi i trasportierit.

Silloset e cimentos

Ne kete impiant eshte projektuar te kete dy sillosa per depozitimin e cimentos me kapacitet $2 \times 30 = 60$ ton.

Furnizimi i silloseve behet me cemento rifuxho nga makinat e transportit cisterna, me forcen e ajrit te komprimuar

Shneket e transportit te cimentos

Shneket jane pajise te mbyllura kane forme tubi brenda te cilit eshte montuar nje aks rreth te cilit ne forme spirali eshte salduar nje shirit llamarine.

Aksi ne te cilen eshte vendosur spirali prej flet llamarine qe puthitet me faqet e brendshme te tubit vihet ne levizje nga nje elektromotor.

Cimentua nga silloset shkarkon ne shnek transportohet ne perziers dhe prej aty hidhen ne betoniere. Shneket montohen ne plan te pjerret me lartesi te kokes se shkarkimit mbi 3.6m, lartesi qe perkon me hinken e perziersit. Sasia e cimentos qe transportohet nga sillosi ne betoniere peshohet automatikisht ne peshoren perkatese qe komandohet nga pulti.

Peshorja e inerteve dhe cimentos

Peshoret sherbejne per percaktimin e sasise se inerteve dhe te cimentos qe do te perdoren per prodhimin e markave te betonit qe kerkon shoqeria.

Ne objektin e projektuar peshorja e inerteve eshte e vecant nga peshorja e cimentos.

Distributori i ujit

Impjanti eshte projektuar te pajiset me distributor per sasin e ujit qe do te hidhet ne betoniere ne vartesi te markes se betonit dhe sasise se betonit qe do te prodhohet. Ky uje do te sigurohet nga depozita.

Distributori siguron ne menyre precize sasin e ujit sipas receptures qe duhet per prodhimin e betonit dhe ne kete menyre do te sigurohet cilesia e projektuar.

Pulti i dhenies se komandave

Pulti eshte qendra ku jepen te gjitha komandat per sasite ne peshe te inerteve, cimentos dhe ujit qe hidhet ne makinat bunker dhe qe e transporton betonin ne destinacion.

Specialisti qe punon ne pultin e drejtimit jep komandat ne tastieren e pultit ne vartesi te recetave te markave te betonit qe do te prodhohet per nje objekt te caktuar, qe percaktohen dhe llogariten nga teknologu i impiantit.

Sistemi elektronik me te cilin funksionon ky impiant, ne menyre atomatike dhe me saktesi teper te larte dergon ne sasi inertet, cimenton dhe ujin ne makinën ne betonier.

Ne pult lejohet te punoje person me kualifikim te mesem ose te lart dhe me aftesi te mjaftueshme profesionale.

Perzierja e inerteve midis tyre, me cimenton dhe ujin behet pjeserisht ne perziers dhe ne betoniere gjat transportit per ne destinacion.

Makina gjate gjithë kohes deri ne hedhjen e betonit duhet te mbahet ne levizje (rrotullim te kazanit) me qellim qe te realizohet nje perzierje sa me e mire dhe qe te mos ndodh ngrirja e betonit ne bunkerin e makines.

LENDA E PARA PER PERGATITJEN E BETONIT DHE PRODUKTET PERFUNDIMTARE

A- PERBERESIT E BETONIT MARKA 300

1- Cimento Portland 42.5 R:	Densiteti:	3.0 gr/cm ³
	Koha e ngrirjes:	
	Fillimi	110 minuta
	Mbarimi	160 minuta
	Rezistenca 28 ditore:	55.0 Mpa
2- Rere natyrale 0-3mm		
Pesha specifike:		2.685 g/cm ³
Moduli i imtesise:		3.1
Masa vellimore		1462 kg/m ³
3- Rere betoni 3-5mm		
Pesha specifike:		2.690 g/cm ³
Moduli i imtesise:		3.86
Masa vellimore:		1462 kg/m ³
4- Granil “1”, (5-10) mm		
Pesha specifike:		2.695gr/cm ³
Moduli i imtesise:		5.9
Masa Vellimore:		1463 kg/m ³
Masa Vellimore:		1463 kg/m ³
5- Granil “2”, (10-20)mm		
Pesha specifike		2.697 gr/cm ³
Moduli i imtesise		7.29
Masa vellimore		1506 kg/m ³
6- Aditiv	Ne vartesi te kerkesave per pershejtim te ngrirjes se betonit	

B- PERBERESIT E BETONIT MARKA 250

1- Cimento Portland 42.5 R	Densiteti:	3.0 gr/cm ³
	Koha e ngrirjes:	
	Fillimi	110 minuta
	Mbarimi	160 minuta
	Rezistenca 28 ditore	55.0 Mpa
2- Rere Natyrale 0 – 3 mm:	Pesha specifike	2.685 g/cm ³
	Moduli i imtesise	3.1
	Masa vellimore	1442 kg/m ³
3- Rere e thyer 3- 5 mm	Pesha specifike	2.690 g/cm ³
	Moduli i imtesise	3.86
	Masa vellimore	1463 kg/cm ³
4- Granil 5-10mm	Pesha specifike	2.695 g/cm ³
	Moduli i imtesise	5.9
	Masa vellimore	1463 kg/m ³
5- Granil 10 – 20 mm	Pesha specifike	2.697 gr/cm ³
	Moduli i imtesise	7.29
	Masa vellimore	1506 kg/m ³
6- Aditiv	Ne vartesi te kohes se pershpejtimit te ngrirjes.	

SASIA E SHPERNDARJES SE INERTEVE NE 1 M³ BETON

Marka e betonit	Rere natyrale 0 – 4 mm	Rere e thyer 4 – 5 mm	Granil “1” 5 – 12 mm	Granil “2” 12 – 30mm
M – 200 p	22%	22%	29%	27%
M – 250 p	21.5%	21.5%	30%	27%
M – 300 p	21.5%	21.5%	30%	27%

Perberja ne sasi e 1 m³ beton

Per marken e betonit 300p

1- Cimento	400 kg/m ³
2- Aditiv	2.125 litra
3- Inerte	1862.5 kg
4- Uje	143.7 litra
5- Lageshtira	6.50 %
6- Pesha vellimore	2408 kg/m ³
7- Konsistenca	11.5cm
8- Raporti uji/cimento	0.373
9-Rezistenca 7 ditore	24.4 Mpa
10-Rezistenca 28 ditore	31.2 Mpa

Per marken e betonit 250p

1- Cimento	360kg /m ³
2- Aditiv	1.625 litra
3- Inerte	1825 kg
4- Uje	161.25 litra
5- Lageshtira	5.00 %
6- Pesha vellimore	2307 kg/m ³
7- Konsistenca	10 cm
8- Raporti uji/cimento	0.503
9-Rezistenca 7 ditore	23.2 Mpa
10-Rezistenca 28 ditore	26.8 Mpa

Per marken e betonit 200p

1- Cimento	320 kg ./m ³
2- Aditiv	1.5 litra
3- Inerte	1912.5 kg
4- Uje	132.5 litra
5- Lageshtira	6.40 %

6- Pesha vellimore	2346 kg/m ³
7- Konsistenca	10 cm.
8- Raporti U/C	0.442
9-Rezistenca 7 ditore	18.6 Mpa
10-Rezistenca 28 ditore	24.8Mpa

Treguesit e mesiperm jane realizuar nga prodhime betoni te markave te ndryshme ne rruge industriale.

Ne nyjen e betonit te projektuar, teknollogu i objektit eshte i detyruar te beje ne rruge laboratorike prova per te percaktuar sasit e inerteve, sasin e cimentos, perqindjet e inerteve dhe raportin U/C per cdo mark betoni dhe per cdo prodhim industrial te kontrolloj marken e realizuar.

Teknologjia e ndertimit, montimit te impiantit dhe prodhimit te betonit eshte e thjeshte dhe perdoret gjeresisht ne vendin tone.

Per ngritjen e objektit do te sistemohet sheshi, do te ndertohen bazamentet e paisjeve, montohen bunkeret, trasportieret, peshorja, silloset e cimentos, shneket e cimentos, distributori ujit, pulti i komandimit me panelin perkates dhe instalimet elektrike.

Prodhimi i betonit industrial sipas kerkesave te vete investitorit do te realizohet duke perdorur, inertet e siguruara nga kariera , rere betoni, granil “1”, Granil”2” cemento, uji dhe aditiv, ne raporte te percaktuara nga teknollogu i objektit, ne vartesi te markes se betonit qe do te prodhohet.

Krahas investimeve per sistemimin e sheshit, ndertimin e bazamenteve, importimin dhe montimin e impjantit te prodhimit te betonit, autobetoniereve, autopompat, per te vene ne perdorim objektin do te kryen dhe objektet ndihmese te permendura me siper.

Ngarkimi i bunkereve me inerte do te behet me fadrom, me motor dizel.

Ndersa procesi i prodhimit te betonit do te realizohet me impiant qe do te vihjet ne pune me energji elektrike. Furnizimi i impantit me inerte do te behet me fadrome me motor dizel me kapacitet kove 2m³.

Ndersa furnizimi me cemento do te behet me cisterna me cemento rifuxho dhe qe do te dergohet ne sillos me pompa qe jane hermetikisht te mbyllura.

Kjo metode furnizimi e silloseve menjanon plotesisht ndotjen e ambientit me pluhur cemento.

Transporti i betonit dhe hedhja e tij ne objekte do te behet me autobetoniere dhe autopompa qe punojne me motorra dizel.

Per ndertim - montimin e impjantit dhe prodhimit e betonit industrial nuk nevojiten instalime te tjera.

Kapaciteti i prodhimit te impiantit te betonit 50 m³/ore.

3.3 PERSHKRIMI I SKEMES TEKNOLOGJIKE TE IMPIANTIT TE PRODHIMIT TE ASFALTO-BETONIT

Impianti i prodhimit te asfaltit, ka destinacion kryesor prodhimin e konglomerateve bituminoze per nevojat e shoqerise per zbatimin e projektit te ndertimit te rruges Qukes-Qafe Plloce.

Konglomeratet bituminoze jane perzierje e agregateve inerte (rere, granile dhe mbushes) ne te nxehte me bitum qe sherben si lidhes dhe qe perdoren per asfaltimin e rrugeve etj.

Konglomeratet bituminoze kane ngjyre te zeze, me arome karakteristike dhe gjendje fizike viskoze. Temperature e nxehjes ne furre e perzierjes se inerteve arrin 180⁰ c.

Gjithashtu prodhohen konglomerate bituminoze te ftohta te cilat kane perdorim te madh ne mirembajtjen e rrugeve, riparimin e demtimit te asfalteve te rrugeve ekzistuese.

Asfalti pasi vendoset ne objekt me pajisjet dhe makinerite perkatese, nga mase vizkoze gradualisht duke u ftohur ngurtesohet dhe ruan aftesine elastike.

Raportet e lendeve perberese dhe granulometria e agregateve perberes dhe bitumit, realizohen mbi bazen e recepturave te percaktuar nga drejtuesi teknik, per cilesi te ndryshme elasticiteti dhe kompaktesie.

Ne raste te vecanta per prodhime asfalto-betoni me kerkesa specifike, karakteristika te rritura, perdoren per pergatitjen e tij, shtesa te ndryshme, si ngjyrues, material plastik, cemento etj.

Inertet, si rera, granili “1”, granili “2”, etj, hidhen me fadrome ne bunkerin e pranimit ne ndarjet perkatese.

- **Depozitat e inerteve**

Sherbejne per ndarjen e materialit sipas madhesis se grimcave, per te respektuar recepturen e projektuar te asfaltit.

Megjense inertet e hedhura ne prodhim, jane dozuar me pare, sistemi i depozitave te inerteve ka funksion te nxjerre ne menyre automatike, nepermjet nje sistemi te caktuar, materialin inert me grimca me diameter me te madh, se percaktimi ne receten e prodhimit.

- **Peshorja**

Peshimi i inerteve sipas nje radhe te caktuar kryhet per secilin material. Peshorja nepermjet nje sistemi te caktuar automatik sipas komandes se dhene, kryen ngarkimin e nje fraksioni ne trasportier dhe pasi arrin sasine e caktuar ngarkon ne trasportier materialet e tjera ne menyre te njepasnjeshme.

Gjate kohes se peshimit te inerteve ne linje te vecante me peshore te vecante, peshohet dhe sasia e bitumit qe futet ne procesin e prodhimit te asfaltit. Pas peshimit materialet inerte dhe bitumi hidhen ne perzieres.

- **Tharja dhe ngrohja**

Inertet me trasportier dergohen ne furre.

Ne pjesen fundore furra eshte pajisur me nje system sprucimi te lendes djegese, ndezja e sprucatorit behet automatikisht dhe temperatura mbahet ne parametrat teknik me ane te termocifteve .

Ne furren e tharjes flaka nuk bie ne kontakt me materialin qe hidhet ne te. Inertet ne furren e tharjes(meqenese ajo eshte e pjerrret te ndihmuar dhe nga disa shnek te vendosur ne trupin e cilindrit te fures) avancojne gjate rrotullimit drejt zonave me te nxehta dhe thahen. Temperatura e tymrave ne dalje te fures eshte me e vogel se ajo e agregatit dhe luhetet ne kufijt 120 –150⁰ c.

- **Perzieresi**

Perzieresi eshte pajisje metalike ne forme kazani me nje sistem lopatash, te cilat sherbejne per perzierjen e inerteve te thata me bitumin.

Ne perzieres bitumi i lengshem dhe i tejnxehur bashkohet me inertet, penetron ne porete dhe carjet e grimcave dhe i mbulon ato me nje cipe te holle me trashesi qe eshte ne funksion te vizkozitetit te lidhesit.

Sasia e bitumit ne perzieres sipas receptures se percaktuar behet ne momentin e hedhjes se inerteve. Ne perzieres inertet e thara me bitumin e lengshem te tejnxehur perzihen dhe mbahen mbi 20 sekonda. Pas kesaj agregati i prodhuar dergohet ne nje kove e cila e shkarkon tashme asfaltin ne silloset e grumbullimit si produkt te gatshem per asfalt.

- **Ngrohja e agregateve**

Pjese perberese e impiantit te prodhimit te asfaltit eshte kaldaja.

Kaldaja punon me lende djegese nafte deh solar dhe ngroh te gjitha agregatet qe perdoren per prodhimin e asfaltit te permendur me larte si inertet ne furren e tharjes, duke perfshire dhe agregatet e tjera,

Ngrohja e bitumit ne cisterna dhe tubacionet e transportit behet me trasmetim nxehtesie me serpentina vaji.

- **Silloset**

Ne silloset e grumbullimit materiali (asfalti i prodhuar) mbahet ne nje temperature rreth 140⁰ c. nga nje sistem ngrohje. Ky sistem eshte nje bashkesi tubacionesh tip radiator qe duke u nxehur nga kaldaja bejne qarkullimin e vajit te nxehur. Tubot jane te vendosur per gjate faqes anesore te silloset ne forme spirale.

- **Serbatoret e bitumit**

Bitumi ne kushte natyrale, ne temperaturen e ambientit eshte pak i rrjedhshem dhe vizkoze. Per ti ulur vizkozitetin dhe per ti rritur rrjedhshmerine, ai nxehet ne temperature deri 180⁰ c . Ngrohja e bitumit deri ne temperaturen e percaktuar me larte behet nga nje sistem radiatoresh me vaj te

tejnxeher nga nje kaldaje qe perdor per djegie lende djegese. Vaji i tejnxeher ne kaldaje qarkullon ne sistemin e tubacioneve te vendosur ne serbatorin e bitumit dhe e ngroh ate ne temperaturen qe kerkohet.

Lenda djegese perdoret ne kaldajen e ngrohjes se bitumit dhe furren e cilindrike te rrotullushme per tharjen e inerteve.

- **Automatizimi**

Impianti i prodhimit te asfalteve eshte prodhim relativisht i ri, me teknologji te perparuar dhe e automatizuar.

Kujdes i vecant eshte kushtuar gjate lidhjes se kontrates per aparaturat e dozimit te lendes se pare, lendes djegese, mbajtjen e temperatures ne parametrat teknik, kapjes se tymrave, pluhurave dhe trajtimit te tyre.

Impianti eshte pajisur me sistem mbrojtës dhe alarmi qe nderhyjne per te modifikuar ose ndaluar impjantin kur vlerat qe tregojne aparatet largohen nga vlerat e lejuara.

- **Sistemi i ajrimit**

Sistemi i ajrimit fut ajer me presion te rritur nga jashte ne furren e nxehtes se inerteve per te ndihmuar djegien, sherben njekohesisht edhe per nxjerrjen e gazeve te prodhuara nga djegia. Gazrat e prodhuar nga djegia para se te dalin ne oxhakun e fures kalojne ne dhomen e filtrimit te gazeve dhe pluhurit. Keshtu ajo eleminon te gjitha tymrat vajore, ndotese te krijuara nga djegia kap pluhurat e imta te inerteve dhe i rikthen ato perseri ne ciklin e prodhimit te asfaltit.

Ne furren e tharjes, nepermjet flakes se hapur te krijuar nga djegia e lendeve djegese materiali nxehtet deri 180⁰ c dhe prej ketej inertet me temperature te larte dergohen ne kulle. Dergimi i materialit pergjate oxhakut te kullës kryhet nepermjet nje trasportieri elevator. Ne kulle jane te instaluar sitat, peshorja e inerteve, bitumit dhe shtesave te tjera, dhomat e perzierjes te konglomeratit.

Kapaciteti i prodhimit te impjantit te asfaltit do te jete 50-70 ton/ore.

4- PERSHKRIM I VENDIT DHE MJEDISIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

4.1 Pershkrim te karakteristikave fizike te zones se projektit

Njesia Administrative **Çerrave**, Bashkia Pogradec, Qarku Korçë. Shtrihet në juglindje të Republikës së Shqipërisë ka siperfaqe fushore (64 %) dhe kodrinore (36 %). Lartësia mbi nivelin e detit varion nga pjesa Veriore, Jugore, Perëndimore prej 900 m dhe pjesa Lindore prej 1800 m (Mali i thatë). Në rrugë automobilistike ndodhet 30 km në largësi nga Qarku i Korçës dhe 8 km në largësi nga qyteti Pogradecit.

- pershkrim i faktoreve klimatike

Klima ne rajonin e Pogradecit eshte e tipit kontinental lokal, me nje temperature mesatare vjetore prej 11°C . Temperaturat mesatare mujore arrijne rreth afersisht 21 °C ne Korrik dhe Gusht, ku maksimumi arrin ne gusht me 34.4 °C. Temperatura mesatare me e ulet eshte gjate Janarit rreth 1.5 °C, me nje minimum prej -17 °C.

Reshjet jane nje prej faktoreve kryesore qe influencojne regjimin klimaterik te zones. Reshjet e shiut variojne gjate vitit dhe luajne nje rol te rëndesishem ne balancen e ujit te liqenit dhe pellgut te tij ujembledhes. Niveli me i larte i reshjeve normalisht shenohet ne Nentor- Janar dhe ne pranveren e vone, zakonisht ne Maj. Reshjet arrijne nivelin me te ulet gjate Korrikut dhe Gushtit . Reshjet mesatare te shiut ne vit ne basenin e liqenit shkojne afersisht 759 mm.

Era me e shpeshte eshte ajo qe fryn nga veriu, sidomos ne vjeshte dhe ne dimer. Ererat qe fryjne nga jugu dhe juglindja dominojne gjate pranveres dhe veres. Ererat e juglindjes dhe lindjes jane te konsiderueshme . Periudhat e qeta dhe me ere ndryshojne gjate dites , vecanerisht ne vere. Mengjeset karakterisohen nga luhatjet mes ererave qe fryjne nga veriu dhe periudhave te qeta. Kushtet e motit ndryshojne mjaft pasditeve, kur fillojne ererat e jugut dhe juglindjes. Shpejtesia mesatare e eres ne rajon eshte relativisht e ulet 3. m/sek.

- pershkrim i sizmicitetit i zones se projektit

Studimet sizmoteknike kane te bejne me te dhenat per termetet , ato lidhin sizmicitetin me shkeputjet aktive. Kushtet e vendosjes strukturore dhe tektonike te ndodhjes se termeteve jane perftuar kryesisht nga analiza pergjithesuese e te dhenave nga gjeologjia, gjeofizika dhe dukurite sizmologjike. Dihet se aktiviteti i sotem termetor lidhet ngusht me strukturen e sotme gjeologjike, me strukturen neotektonike te vendit tone. Eshte tashme e mirenjohur dhe e pranuar nga shumica e studiusve se shkeputjet tektonike jane burimet e clirimit te energjise sizmike. Termeti ndodh atje dhe atehere ku edhe sforcimet e lindura deformimet tektonike , tejkalojne kufirin e fortesise se lendes pergjate ketyre shkeputjeve.

Zona Korce-Oher eshte nje zone e brendshme qe permban strukturat Pliocen-Kuartenare, grabenin e Ohrit dhe gjysem grabenet Korce-Erseke , te cilat kane ne pergjithesi shtrirje V.

Gjate saj janë rregjistruar termete nga me te fuqishmit si ne 18 shkurt 1911 Ms=6.7 , 26 Maj 1960 Ms= 6.4 .

- *Pershkrim i gjeologjise dhe tokes ne zonen e projektit*

Zona e Pogradecit është e pasur sidomos sa u përket formacioneve gjeologjike. Në këtë zonë janë të pranishme pothuajse të gjitha llojet e formacioneve shkëmbore si:

a) karbonate, b) magmatike dhe c) poroze,

1- Formacionet e karbonateve përfaqësohen nga gurët qëlqerorë dhe dolomitet, të cilat janë të pasura me faunën e çdo epoke . Formacionet e flishit janë të pranishme në këtë zonë, por jo të shpërndara gjerësisht. Së bashku, karbonatet janë të pranishme në formacione të tjera si shiste argjilore, konglomerate, gurë qëlqerorë silicorë dhe argjilë. Këto formacione mbulohen nga një shtresë bimësie që arrin nga 0.2-0.5m në disa metra në vendet ku këtë e lejon ndërtimi gjeomorfologjik. Shpërndarja e tyre në zonë nuk është uniforme.

2- Formacionet magmatike përfaqësohen kryesisht nga shkëmbinj të ofiolite dhe vullkano-sedimanetare. Ato zënë një sipërfaqe të konsiderueshme të zonës. Trashësia e shtresave tokësore të bimësisë mbi këto formacione është zakonisht nga 0.5-1.5m për shkak të mungesës së pyjeve dhe pjerrësisë së madhe të shpateve. Shpërndarja e tyre në zonë nuk është uniforme.

3- Formacionet poroze (Kuaternari-K). Këto formacione përfaqësohen kryesisht nga sedimentet aluviale-proluviale të liqenit, si rëra, zhavorri, llumi dhe sedimentimet fluvio-glaciale si rëra, zhavorri dhe llum. Ato janë të shpërndara në të gjithë zonën në formën e aluvioneve, proluvioneve dhe deluvioneve. Trashësia e tyre në qendër të zonës arrin në 50-60m.

Liqeni i Pogradecit është formuar rreth 2-3 milionë vjet më parë dhe është një prej liqeneve më të vjetër në botë. Liqeni ka origjinë tektonike, i përket periudhës gjeologjike terciare si pak liqene të tjerë në botë. Vetë liqeni i Ohrit është i formuar mbi një strukturë me orientim meridianor dhe shtyrje horizontale përgjatë lidhjes kryesore ndarëse tektonike: Bilisht – Korçë – Dibër. Forcat tektonike kanë formuar një pjesë të konsiderueshme të terrenit të pellgut ujëmbledhës të liqenit të Pogradecit.

Struktura e shtratit shkëmbor të zonës së pellgut ujëmbledhës përfshin shkëmbinj të llojeve, përbërjeve dhe moshave të ndryshme, kryesisht shkëmbinj metamorfik paleozoik dhe magmatik. Përbërjet mezoike datojnë qysh në Triasik dhe kanë dy lloj faqesh: sedimente konglomerate karstike, rërë, argjilë dhe sedimente karbonatike si gurë rrasash, depozita qymyri, gur qëlqeror

dhe dolomite, duke krijuar rrugë kalimi për ujin nëntokësor mes pjesëve të konsiderueshme të Malit të Thatë.

Sedimentet cenozoike përbëhen nga shtresa të Pliocenit dhe Kuarternarit. Sedimentet e Pliocenit gjenden në pjesën veriore dhe perëndimore të Luginës së Prespës.

- *Pershkrim i ujerave sipërfaqesore dhe nëntokesore në zonën e projektit*

Liqeni i Pogradecit është një prej zonave turistike me të rëndësishme në Shqipëri. Liqeni kufizohet në lindje nga Mali i Thatë dhe në perëndim nga mali i Mokres në pjesën Shqiptare. Malet që rrethojnë basenin liqenor kanë një lartësi përafërsisht mbi 2000 m. Malet me lartësi mesatare nën 2000 m mbi nivelin e detit janë Pelisteri, Galicica, Stogovo, Karaosman, Jblanica, Ilinska, Plakenska dhe malet Bigla.

Kufijet e zonës së mbrojtur ndodhen të gjitha në rrethin e Pogradecit dhe përfshijnë katër komuna, Hudenisht, Cerrave, Bucimas dhe Trebinje, qyteti i vogël i Pogradecit.

Liqeni i Pogradecit ka vlera të larta të biodiversitetit. Liqeni njihet për praninë e specieve të rralla dhe një numër të madh specimesh endemike. Liqeni ka gjithashtu vlera të mëdha kombëtare dhe ndërkombëtare për shkak të trashëgimisë kulturore specifike që ka zona.

Liqeni i Pogradecit është liqeni tektonik më i thellë në Ballkan (289 m, liqeni i 7-të më i thellë në Evropë). Ai ka një sipërfaqe prej 358.2 km² dhe vetëm 109 km² i përkasin Shqipërisë. Liqeni ndodhet 695 m mbi nivelin e detit.

Bregu i Liqenit të Pogradecit/Ohrit është 87.5 km i gjatë, nga të cilat 56 km i përkasin Maqedonisë dhe 31.5 km Shqipërisë. Vetë liqeni ka një gjatësi maksimale prej rreth 30 km dhe një gjerësi që varion nga 11.2 km në 14.5 km. Thellësia maksimale është 289 m, kurse thellësia mesatare 164 m.

Niveli i ujit të liqenit të Pogradecit ka rënë gradualisht me kalimin e kohës. Kjo duket edhe në tarracat përgjatë bregut të liqenit. Në breg dallohen 2-3 tarraca dhe ndoshta 5 në një pjesë të bregut të liqenit, të cilat tregojnë nivelet e mëparshme të liqenit. Në pjesën veriore të liqenit në Maqedoni, është një tarracë nën sipërfaqen e liqenit. Tarracat përgjatë buzëve të liqenit përfaqësojnë disa nga fushat më produktive për bujqësinë (Bucimas, Lin, Struga, Ohër). Ishujt e hershëm të Linit dhe Ohrit tashmë janë shndërruar në gadishuj. Fusha e Linit mbart gjurmë të dukshme të origjinës së saj liqenore (sipërfaqet e lagështa dhe ngjyra e zezë e aluviumit).

Burimet e Shën Naumit ndodhen në bregun lindor të liqenit, afër kufirit Shqiptaro-Maqedonas. Uji i burimit vjen nga vargmali i Galicicës, si nga reshjet, ashtu edhe nga ujërat e liqenit të Prespës. Hulumtimet e prurjeve të burimeve janë bërë që në vitet 1949/50 në stacionin hidrik ku niveli i ujit monitorohet në mënyrë konstante. Gjatë vitit bëhen edhe matje direkte të rastit të prurjeve të ujit. Këto matje tregojnë se prurja nga burimet e Shën Naumit variojnë nga 4.0 në 12.0 m³/s, me një prurje mesatare $Q=7.50\text{m}^3/\text{s}$. Prurja maksimale arrihet në periudhën midis Majit dhe Qershorit, kurse prurja minimale ndodh në fund të vjeshtës dhe gjatë periudhës së thatë, ose në periudhën midis Shkurtit dhe Marsit – minimumi i dimrit.

Burimet e Tushemishtit janë pjesë e burimeve nëntokësore masive të Galicicës – Malit të Thatë që derdhen në liqenin e Pogradecit/Ohrit. Matjet hidrike në burimet e Tushemishtit kanë filluar në vitin 1971. Prurjet mesatare afatgjata llogariten të jenë 2.5m³/s. Në liqenin e Pogradecit/Ohrit derdhet edhe një sasi uji përgjatë bregut të liqenit nga burimet e Shën Naumi deri në burimet e Tushemishtit (burime nënujore).

Lumi i Çërravës është lumi më i madh në anën shqiptare që rrjedh në liqenin e Pogradecit/Ohrit. Ai ndodhet në pjesën jugore të liqenit dhe rrjedh nga burime të ndryshme në zonën malore të Gurit të Kamjes, në një lartësi 1538 m mbi nivelin e detit. Përgjithësisht, rrjedha është e drejtuar drejt lindjes deri në fshatin Çërravë, më pas, në veri, afër fshatit Lubanishte në anën maqedonase.

Pellgu ujëmbajtës i lumit të Çërravës në Shqipëri është 87 km²; ai është 18 km i gjatë dhe me një lartësi mesatare rreth 1100 m, dhe me pjerrësi mesatare të shpateve prej 20 %. Deri tani nuk është bërë ndonjë hulumtim hidrik i këtij lumi. Ka plane për ndërtimin e një stacioni hidrik në anën shqiptare të lumit të Çërravës si pjesë e Projektit të Ruajtjes së Liqenit të Pogradecit/Ohrit. Sipas studimeve të mëparshme hidrike në rajon dhe duke përdorur morfometrike rreth zonës ujëmbledhëse, prurja mesatare përlllogaritet të jetë afërsisht 1.5 m³/s. Lumi i Çërravës përshkron fshatrat Beragozhd, Stropckë, Leshnicë, Çërravë e vazhdon deri sa del jashtë teritorit shtetëror poshtë fshatit Peshkëpi duke u derdhur në Liqenin e Ohrit disa dhjetra metra në veri të Shën Naumit.

Lumi i Pogradecit është një përrua i vogël që rrjedh përmes qytetit të Pogradecit. Zona e tij ujëmbledhëse është 10.6 km² dhe e ka origjinën nga malet rreth qytetit. Karakteristika kryesore e Lumit të Pogradecit është shpati i ngritur i shtratit të tij prej rreth 9.2%, gjë që përbën një kërcënim për qytetin e Pogradecit gjatë stuhive të mëdha. Për ta mbrojtur qytetin nga përmytjet, shtrati i lumit është bonifikuar me beton në të gjithë sektorët urbanë.

Për lumin e Pogradecit ka të dhëna hidrike për periudhën 1974-1990. Këto të dhëna tregojnë për një prurje mesatare vjetore prej 0.250 m³/s.

Edhe lumi i Verdovës është një përrua i vogël që derdhet në pjesën jugperëndimore të liqenit të Pogradecit/Ohrit. Pellgu ujëmbajtës i këtij përroi është 8.4 km², i gjatë rreth 8 km dhe me një pjerrësi të shtratit prej 4.5 %.

Në anën shqiptare ndodhen edhe disa përrenj të vegjël të përkohshëm dhe burime të vogla me prurje mesatare vjetore prej deri 100 l/s (burimet e Linit).

4.2 Pershkrim i biodiversitetit ne zonen e projektit

Problemet e biodiversitetit perbejne aktualisht nder problemet me me rendesi ne rruzullin tokesor. Termi biodiversitet eshte shume kompleks dhe si i tille, zhvillimi dhe percaktimi i strategjive te pershtatshme per mbrojtjen e tij, shoqerohet me nje proces te veshtire zgjedhjesh dhe vendimmarrjesh. Biodiversiteti perben teresine e llojeve dhe ekosistemeve ne nje rajon, apo ne gjithe rruzullin tokesor. Ekosistemet jane te nje rendesie te vecante sepse ato perbejn bazat per ekzistencen e llojeve. Cenimi i tyre, si rezultat i aktiviteteve te ndryshme ekonomike shoqerore perben nje shqetesim per njerezit dhe studiuesit . Vlera e nje biodiversiteti te larte per njerezimin jepet para se gjithash nepermjet funksionit te tij si stabilizator i biosferes dhe si burim direkt i prodhimit.

- pershkrim i habitateve kryesore ne zonen e projektit

Në aspektin ekologjik, larmia biologjike, flora dhe fauna në tërësinë e saj në këto zone paraqet një pamje të një larmie përfaqësuese, pra të një rajoni gjeografik më të gjërë, mbizoterojnë zonat e zhveshura me bimesi të ulet shkurre makjet mesdhetare si mare, mersine, shqope, prall, xane, gjeneshter, shkoze , mrete etj, ka pak zona me dushke dhe mungojne pyjet e larta, gjithashtu dhe fauna e zones eshte e varfer

Fitocenozat e bimesise barishtore shume te larmishme nga perberja e llojeve, gjenden ne te gjitha zonat fitokilmatike te Shqiperise.megjithese fitocenozat barishtore nga ana e fizionomise ne pergjithesi duken relativisht te peraferta, ato ndryshojne midis tyre nga perberja flojistike ne varesi te faktoreve ekologjike. Me perjashtime te pakta, gati ne te gjitha fitocenozat dhe bashkeshoqerimet barishtore gjenden perfaqesues te familjes graminore (Graminaceae).

- pershkrim i faunes ne secilin habitat dhe statusit te ruajtjes kombetar dhe nderkombetar te tyre

Duke analizuar komponentet e vecante te natyres shqiptare (ndertimin gjeologjik, relieving, klimen, bimesine etj) eshte theksuar origjinaliteti dhe shumellojshmeria e tyre. Ketij rregulli te pergjithshem I nenshtrohet edhe bota e kfasheve te egra, e cila eshte e shumellojshme dhe ne disa raste oridgjinalle dhe endemike. Nder elementet e mjedisit natyror rendesi te vecante per rritjen e perhapjen gjeografike te kafsheve te egra kane klima, bimesia, pasurite ujore, relieve etj.

Ne tresine e tyre pasurite e medha ujore te Shqiperise , krijojne kushte te volitshme jetesore per kafshet ne cdo zone gjeografike, ne cdo lartesi dhe ne cdo stine te vitit.

Fauna tokesore

Ne kete grup te madhe te faunes hyjne kafshet gjitare te tokes (mishngrenese dhe barngrenese) , shpezet, zvarraniket, amfibet , insektet etj

Te gjitha kafshet tokesore te vendit tone jane pothuajse te njejta ose te ngjashme me ato te krejt mesdheut , por sidomos me ato te Mesdheut europian. Ky unitet faunistik lidhet me faktin qe gjithë Mesdheu formon nje njesi me vete faunistike ne kuadrin e zones Paleoarktike, e cila nga ana e vet ben pjese ne nje njesi me te madhe faunistike, ne treven Holarktike. Ne pergjithesi fauna e Mesdheut nuk dallon per forma te shumta endemike, por ajo permendet per numrin e madh te perfaqesuesve te disa llojeve te kiroptereve, butakeve, zvarranikeve, te disa insekteve etj. Fauna tokesore e vendit tone me gjithë demtimet eshte ende e pasur. Ajo ka perfaqesuesit e vet ne te gjitha krahinat e zonat gjeografike te vendit dhe ne te gjitha lartesite , ku formohen biocenoza te caktuara.

- pershkrim i zonave te mbrojtura prane vendit ku propozohet te zbatohet projekti perfshi edhe monumentet natyrore te mbrojtura me ligj.

Lidhja e objektit me rruge ekzistuese dhe ushtrimi i aktivitetit nuk prek zonat turistike dhe zonat e mbrojtura, sepse ne afersi nuk ka zona te mbrojtura me status te vecante. Eshte per t’u theksuar se nuk ka asnje veper arti te ndertuar nga njeriu.

4.3 Pershkrim i cilesise se mjedisit dhe ndikimeve ekzistuese

- cilesia e ajrit ne zonen e studiuar per hartimin e raportit te thelluar te VNM-se

Persa i perket cilesise se ajrit ne zone ai konsiderohet me parametra brenda normave duke qen se ndodhet larg zonave te banuara dhe nuk eshte i ndotur nga veprimtarite e industrise. Edhe zhvillimi i aktivitetit nuk do te shkaktoj ndotje te ajrit sepse nuk do te kete emetime te gazeve ndotes.

- niveli i zhurmave ne zonen e studiuar per hartimin e raportit te thelluar te VNM-se

Ne afersi te projektit nuk ka veprimtari te cilat te shkaktojne zhurma mbi nivele te lejuara.

- Administrimi i mbetjeve ne zonen ku propozohet projekti

Administrimi i mbetjeve urbane në vendin tonë është i decentralizuar. Në pjesën më të madhe të qyteteve shërbimet e mbledhjes dhe transportimit të mbetjeve kryhet nga kompani privatë të menaxhimit të mbetjeve, të cilat janë të kontraktuara nga bashkitë. Në shumicën e bashkive të

vendit, tarifa për menaxhimin e mbetjeve përfshin grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve deri në venddepozitim. Zonat rurale në vendin tone nuk janë të mbuluara akoma nga shërbimet e menaxhimit të mbetjeve. Pjesa më e madhe e mbetjeve të këtyre zonave depozitohen nëpër lumenj ose në anë të rrugëve të cilat pastrohen nga Ujërat dhe në këtë mënyrë zhvendosen në një pjesë tjetër toke dhe në fund në rrjedhjet ujore.

Në zonen ku do të zhvillohet projekti nuk ka prodhim mbetjesh të demshme sepse nuk është një zonë e zhvilluar industriale. Mbetjet që krijohen janë mbetje urbane nga aktiviteti i perditshem i banoreve të fshatit të cilat administrohen nga NJA Cerrave.

4.4 Pershkrim i karakteristikave sociale të zonës ku propozohet projekti

- Njesia e qeverisjes vendore që administrojnë zonën ku zbatohet projekti

Zona ku do të zhvillohet aktiviteti ndodhet në juridiksionin e NJA Cerrave, Bashkia Pogradec.

- popullsia dhe aktivitetet kryesore ekonomike të zonës

NJA Çërravë ka mundësi të konsiderueshme për investime në fushën e bujqësisë në saj të tokave me strukturë të pasur me lëndë organike dhe klimës së favorshme. Për shkak të metodave akoma tradicionale të prodhimit të frutave, perimeve, mishit dhe produkteve të qumështit duke përdorur më pak shtesa artificiale, pesticide dhe kimikate pra për një cilësi bio të produkteve, kjo zonë është bërë e mirënjohur si një prodhues i nivelit rajonal dhe kombëtar. Territori i NJA Çërravë zotëron një fond toke prej 8500 ha nga e cila: -3458 ha tokë bujqësore, -2000 ha pyje dhe kullota, -3048 ha tokë inproduktive, urbane, sipërfaqe ujore, rezervuare etj.

Sistemet tradicionale vazhdojnë të jenë baza për mbajtjen e bagëtive, sidomos të dhive dhe deleve. Në kohët e sotme, racat e kafshëve janë përzier dhe përfshijnë edhe bagëti me rendiment të lartë dhe raca autentike. Prodhimi i mishit dhe qumështit është një faktor i rëndësishëm për ekonominë lokale dhe rajonale.

Zona ka një traditë të gjatë në prodhimin e shumë produkteve bujqësore dhe derivateve nga aktiviteti blegtoral. Prodhimet bujqësore parësore përfshijnë frutat (drurë frutorë dhe vreshta), grurin, misrin dhe perimet. Lajthitë, gjithashtu, konsiderohen si një burim. Në zonë praktikohet mbajtja e bletëve dhe prodhimet e mjaltit sigurojnë të ardhura për njerëzit vendas. Prodhimi tradicional i verës është gjithashtu një praktikë shumë e zakonshme.

Krahas resurseve mbitorësore të sipër përmendura nëntoka e territorit të Çërravës është e pasuruar me shtresa qymyr mbajtëse të tipit “linjiti” të cilat ndodhet në fshatin Alarup dhe fshatin Pretushë. Cilësia dhe sasia e këtij minerali është veçanërisht e lartë. Para viteve 1990

minierat e mineralit të qymyri që ndodheshin në fshatin Alarup dhe Pretushë plotësonin nevoja të industrisë për lëndë djegëse të vendit tonë, si dhe eksportohej në vende të huaja. Mbas këtyre viteve shfrytëzimi i këtyre minierave është pezulluar si rezultat i mosqasjes së investitorëve për të investuar. Vënia në përdorim për shfrytëzimin e këtyre minierave do të ndikonte ndjeshëm edhe në punësimin e banorëve të komunës dhe rritjes së mirëqënies. Një tjetër burim janë edhe mineralet shkëmbore, e cila ka gjetur një përdorim të gjerë në sektorin e ndërtimit si; rrugë, ura, objekte banimi etj

Peshkimi dhe akuakultura

Peshkimi në liqenin e Pogradecit është një burim i rëndësishëm të ardhurash për popullsinë që jeton në zonën e mbrojtur.

- përdorimi i tokës në zonën e projektit

Zhvillimi i projektit do të zhvillohet vetëm brenda zonës së miratuar. Projekti nuk do të kërkojë tokë shtesë për zhvillimin e tij.

- Vlerat dhe objektet monumentale dhe arkeologjike në afërsi të zonës së projektit

Lidhja e objektit me rrugë ekzistuese dhe ushtrimi i aktivitetit të shfrytëzimit nuk prek zonat turistike dhe zonat e mbrojtura, sepse në objektin e projektuar dhe për rreth nuk ka zona të mbrojtura me status të vecantë.

5- VLERESIMI I NDIKIMEVE

- Metoda e zbatuar për parashikimin e ndikimeve në mjedis

Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqen hapat e më poshteme:

-Njohja me projektin dhe teknologjinë etj.

-Njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis.

-Njohja me vlerën natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes ku do të zhvillohet aktiviteti

-Njohja me infrastrukturën ekzistuese dhe nevojën për infrastrukturë të re për projektin.

-Njohja me lëndët e para që do të përdoren për zhvillimin e aktivitetit.

Duke njohur teknologjinë Linjes së fraksionimit dhe impiantin e prodhimit të betonit dhe asfalto betonit u indentifikuan ndikimet e mundshme negative në çdo receptore - përberës të mjedisit në linjen e prodhimit.

Identifikimi i ndikimeve – Përmes të cilit u përcaktua nderveprimi mjedis-projekt i impianteve dhe u indentifikuan ndikimet e mundshme gjatë fazës që do të zhvillohet aktiviteti sipas receptoreve të mjedisit.

Vleresimi i ndikimeve – Ekspertet mjedisore te fushave te ndryshme bene perpjekje per matjen e gravitetit te ndikimeve . Vleresimi i Sinjifikances ka te beje me vete rendesine e ndikimeve dhe eshte faza me e rendesishme per zbatuesit e projektit sepse argumenton çdo ndikim negativ dhe perafiron ate me objektivisht me teresine e bashkeveprimeve midis projektit dhe mjedisit. Kriteret e perdorur per vleresimin e rendesise se ndikimeve variojne dhe drejtohen kryesisht nga vlerat e mjedisit te ndikuar.

- *shtrirja fizike dhe kohezgjatja e ndikimeve te identifikuarra (Shkalla)*

Shtrirja fizike- Vlereson siperfaqen apo dimesionin hapsinore te nje ndikimi te dhene ne raport me burimin qe gjeneron ate ndikim, p.sh. ndikimi ne toke nga linja e prodhimit te betonit eshte nje ndikim saktesisht i percaktuar i cili mund te matet , por ne se do te kete erozion te tokes ndikimi rritet ne permasa fizike te siperfaqes ku do te instalohet linja.

- **Kohezgjatja e ndikimit** – Vlereson se sa do te zgjase nje ndikim i caktuar ne dimesionin kohe (ndikim i perhershem apo i perkoshem).

-**Kthyesmeria** –Vlereson mundesin e kthimit te mjedisit te ndikuar ne gjendjen e tij te me pareshme (aftesia per tu rehabilituar dhe regjeneruar)

-**Rendesia** – Realizon nje vleresim total te tre permasave te mesiperme dhe njekohesisht thekson vemendjen qe duhet patur per administrimin e ndikimit.

Ndikimet e parashikuara nuk kane shtrirje te madhe fizike. Zhurmat qe krijohen gjate proceseve te punes nuk perbejn ndotje akustike. Koha ne te cilen do te jene te pranishme keto zhurma eshte vetem gjate dites, meqenese ne linje do punohet vetem me nje turn. Niveli i zhurmave te ketyre mjeteve ne largesi nuk do te jete i madh dhe do te jete konform normave ne fuqi.

Ndikimet e identifikuarra nga zhvillimi i aktivitetit jane ndikime direkte ne mjedis.

5.1 Ndikimet e mundshme ne shendetin e njerezve

Zhvillimi i aktivitetit te linjes se fraksionimit dhe prodhimit te betonit e asfalto betonit nuk ka ndikime ne shendetin e popullsise se zones. Ky aktivitet nuk perdore lende te rrezikshme per shendetin e punonjesve si dhe te popullsise perreth zones dhe si rrjedhim nuk ndikon negativisht tek ata. Ne projekt nuk jane parashikuar ndryshime ne popullsine e zones, te zhvendosjes se saj, per shkak te ketij projekti. Ne sheshin e zbatimit te projektit nuk ka patur qender te banuar.

Gjate fazes se funksionimit te linjes se fraksionimit dhe impiantit te prodhimit te betonit e asfalto betonit nuk ka ndikime negative ne shendetin fizike dhe mendor te popullsise, por ka efekte pozitive ne punesimin direkt te popullsise se zones duke rritur keshtu edhe nivelin e jeteses se tyre dhe duke i ardhur ne ndihme ndertimit te rruges.

5.2 Nivelet dhe ndikimet e zhurmave

Burimet e zhurmave janë në sipërfaqe. Cdo burim përhap vlerë zhurmë. Fusha akustike që rezultojnë varet nga karakteristikat e absorbimit dhe reflektimit të të gjitha pengesave ekzistuese, ndërmjet burimit dhe receptorit.

Shoqëria është kujdesur të importojë nga jashtë pajisje bashkëkohore dhe në gjendje të mirë teknike, në mënyrë të tillë që zhurmat e krijuara prej tyre të mos sjellin ndotje akustike dhe të jenë të demshme për mjedisin dhe shëndetin e punonjësve.

Ndikimet e zhurmave gjatë fazës funksionale do të vijnë nga mjetet që do të sjellin lëndet e para në linjë, pajisjet e instaluar për thyerjen dhe fraksionimin e materialeve inerte dhe për përzierjen e agregateve për prodhimin e betonit të gatshëm sipas markave të caktuara. Niveli i zhurmave të këtyre mjeteve transportuese është i atij niveli që nuk influencën si për të punësuarit dhe për banorët dhe gjallesat për rreth tij. Koha në të cilën do të jenë të pranishme këto zhurma është vetëm gjatë ditës, meqenëse në objekt do të punohet vetëm me një turn. Niveli i zhurmave të këtyre mjeteve në largësi nuk do të jetë i madh dhe do të jetë konform normave në fuqi.

5.3 Ndikimet në rrugë lokale dhe transport

Gjatë instalimit të linjës së fraksionimit të inerteve dhe prodhimit të betonit e asfaltit do të kemi ndryshime në mbulesën fizike e biologjike të tokës, por kjo nuk do të sjell rritje të mundësive së fenomenit të erozionit sepse shoqëria do të marrë masat e duhura. Zhvillimi i aktivitetit nuk do të sjell shtim të trafikut të automjeteve të zonës. Mjetet që do të sjellin lëndet e para do të levizin me shpejtësi të kontrolluar në mënyrë që të ulen rreziku i aksidenteve.

5.4 Ndikimet në florë dhe faunë

Ky projekt nuk sjell shkatërrim të rëndësishëm të habitateve natyrore.

Nga ky aktivitet nuk demtohet flora dhe fauna e rrezikuar e përcaktuar në VKM nr. 804 datë 4.12.2003 “Për miratimin e listës së specieve të florës Shqiptare, që vihen në mbrojtje” Ndikimet negative mbi faunë do të jenë të ndryshme, mbi klasa të ndryshme të saj. Po të referohemi pasurisë së zonës në faunë del se klasa që ka ndikim të rëndësishëm është ajo e zvarranikeve, por specie që do të preken nuk figurojnë ndër ato të rrezikuara, mbrojtura endemike apo kërcënuara.

Nuk pritet ndryshim i ekosistemit pasi shoqëria është dhe do të tregohet mjaft e kujdesshme në zbatimin e teknologjive dhe metodave për fraksionimin e inerteve dhe prodhimin e betonit si dhe do të jetë e gatshme të zbatojë të gjitha masat që do të rekomandohen për uljen e ndikimit.

Ndërsa për të menjauar erozionin nga ujërat e rreshjeve atmosferike në perimetrin përreth objektit do të ndërtohen kanale dhe kuletat që ujërat të drejtohen në zona që nuk demtojnë tokën si dhe habitatet e florës dhe faunës së zonës.

5.5 Ndikimet ne toke

Gjate procesit te fraksionimit te inerteve dhe prodhimit te betonit sasia e inerteve perpara se te hidhet ne autobetoniere peshohet pra ajo eshte me mase te caktuar nuk ka shkarkime te teperta ne mjedis.

Nje sasi fare e vogel te mbetjeve nga puna ne linjen e betonit eshte rreth 0.5 % mase e cila riciklohet per riperdorimin ne linjen e pergatitjes se betonit.

Persa i perket mbetjeve nga larjet e mjeteve te transportit te betonit sebashku me sasine e ujit qe realizon larjen e tyre kalojne ne vasken e ndertuar per dekantim te masses se ngurte. Uji pas qendrimit ne vasken e pare kalon ne vasken e dyte dhe me pas shkarkohen ne mjedisn uJOR prites, theksojme se nuk do permbaje mbetje inerte dhe nuk do te jete ndotes per ujerat e lumit.

Gjate pastrimit te vaskave , llumrat qe kane dekantuar ne to do te depozitohen ne sheshin e percaktuar te depozitimit.

Subjekti realizon larjen ne nje vend te caktuar brenda sheshit te objektit por referuar gjendjes krahas arritjes kerkohet pastrim korrekt te kanalit te ujerave prej llumit te larjes se mjeteve dhe dherave te sheshit gjate reshjeve.

5.6 Ndikimet ne uje

Keto procese teknologjike nuk shoqerohen me shkarkime te lengeta te rrezikshme . Në procesin e prodhimit te betonit uji do të dozohet dhe perzihet me inertet dhe çimenton ne sasine e kerkuar per prodhimin e betonit sipas markave dhe si rrjedhim nuk do te kete uje qe te dale nga procesi teknologjik.

Ajo sasi e paket e ujit qe mund te derdhet kalon ne vaska dekantuese dhe me pas i bashkohet linjes se shkarkimit.

Ujerat qe dalin gjate larjes se autobetoniereve dhe reshjeve orientohen permes kanaleve perkatese ne vaskat e dekantimit dhe me pas per ne mjedisin uJOR prites.

Projekti nuk ndikon negativisht në modelin drenazhues të zones. Ai do te zbatohet vetem ne nje sipërfaqe shume te kufizuar dhe pa perdorim masiv te ujit. Zbatimi i projektit nuk çon në ndryshime hidrografike te nivelit të ujrave, të rrugëve ujore, të rrjedhjes të ujrave nëntokësore dhe sipërfaqësore etj. Ky projekt nuk ka ndikim në hidrologjinë bregdetare per shkak se ndodhet larg vijes bregdetare.

5.7 Ndikimet ne ajer

Referuar natyres se procesit nuk ka sasi gazesh te emetuara ne atmosfere por vetem perhapje te pluhurit. E cila eshte prezente ne shesh gjate kohes se thate nga levizja e mjeteve ne kohen e ngarkimit te materialit ne bunkeret e depozitimit e ndonje rast tek peshimi e furnizimi me cimento.

Linja e prodhimit te inerteve me thyerje fraksionim eshte me teknologji moderne.

Te gjitha paisjet jane te hermetizuara dhe pluhurat qe krijohen gjate thyerjes ne shkallen e pare, te dyte te coptimit, siten vibruese etj behet sperkatje me uje per elemenimin e tyre.

Gjithashtu per shmangien e pluhurit behet sperkatje me uje her pas here ne sheshin e punes sidomos ne kohe te thate dhe me ere si dhe hermetizim sa me i mire ne linjen e furnizimit nga silloset ne perzieres. Shneket e transportimit te cimestos nga sillosat ne perzieres jane te mbuluar dhe te hermetizuar. Gazet prej mjeteve jane ne interval kohore te shkurtera e pa ndonje ndikim ne mjedisin perreth. Per te pakesuar gazet toksike makinat e transportit dhe ngarkimit do te jene te pajisur me marmite me katalizatore te kapjes se gazeve toksike.

5.8 Ndikimet ne klime

Faktoret e formimit te klimes grupohen ne faktore kozmike, planetare (Tokesore) dhe lokale. Ne grupin e pare hyjne karakteristikat e qendrueshme ose te ndryshueshme te Diellit dhe te hapesires kozmike, ne grupin e dyte karakteristikat e te gjithe siperfaqes se tokes dhe te atmosferes, kurse ne grupin e trete karakteristikat e qendrueshme ose te ndryshueshme te ajrit dhe te tokes se vendit ne fjale. Ne teresine e faktoreve klimeformues eshte e veshtire te behet nje renditje e sakte , per arsye se secili prej tyre ndikon vazhdimisht ne formimin e klimes, nderkohe qe roli dhe rendesia e tyre eshte e ndryshueshme ne vende te ndryshme. Ne rast se do te benim nje fare renditje, atehere ne radhe te pare duhet te vendosim rrezatimin diellor, sepse sasia dhe intensiteti i tij percaktojne karakteristikat themelore te klimes.

Gjate zhvillimit te projektit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtim te eres, ne sasine e reshjeve. Pra kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

5.9 Ndikimet ne ekonomi

Ndikimet ne ekonomi te ketij aktiviteti jane te medha duke qen se i vjen ne ndihme shoqerise per ndertimin e rruge Qukes-Qaf Plloce.

5.10Ndikime mbi trashegimine kulturore

Zona ku do zbatohet projekti nuk njihet si zone e mbrojtuar me vlere arkitektonike dhe kulturore , pra nuk kemi ndryshime apo demtime te saj duke qene se nuk ekziton ne kete territor.

Aktiviteti qe do te zhvillohet nuk prek zonat turistike, zona te mbrojtura, zona arkeologjike, arkitekitektonike, objekte te trasheguara dhe te ndertuara nga njeriu me rendesi historike, sepse

ne kete zone ato nuk ekzistojne. Eshte per t’u theksuar se ne kete zone nuk ka monumente kulture, zona arkeologjike dhe gjeomonumente.

5.11 Ndikimet me natyre nderkufitare

Zhvillimi i aktivitetit ndodhet brenda territorit te vendit tone dhe nuk ka ndikime me natyre nderkufitare.

6. MASAT QE DUHEN MARR PER ELEMENIMIN / MINIMIZIMIN E NDOTJEVE

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne marrjen e masave per uljen e ndotjeve gjate procesit te fraksionimit te inerteve dhe prodhimit te betonit, si te pluhurit ne ajer, zhurmave, erozionet si dhe uljen e efekteve negative hapsinore ne territor , faune dhe flore.

6.1 Masat ndaj erozionit

Erozioni është një fenomen që rrezikon tokën ose burimin më të rëndësishëm mjedisor. Ai është një fenomen natyror që kë të bëjë me gërryerjen, ç’vendosjen dhe transportin e lëndëve të ngurta ose materialit tokësor kryesisht nën forcën e veprimit të ujit, akullit ose erës. Erozioni vepron në kundërshti me ekuilibrin natyror të ekosistemeve. Në një këndvështrim të përgjithshëm, nevojitet një kohë shumë e gjatë për të kompensuar humbjen e lëndës të shkaktuar nga erozioni për një kohë fare të shkurtër. Disa nga faktorët që influencojnë erozionin janë : -sasia dhe intensiteti i reshjeve -kushtet e relievit (pjerrësia) dhe mënyra e përdorimit të tokës -degradimi i mbulesës bimore (ç’pyllëzimet, zjarret, mbikullotja etj) -modifikimi i topografisë (p.sh. ndertimi i rrugëve, qendrave urbane etj) - politika e administrimit të ujrave (kanalizimet, veprat hidrike, pritrat, etj) Masat e luftës kundër erozionit synojnë parandalimin e rreziqeve për mjedisin human ose konservimin e burimeve jetësore. Parandalimi dhe kufizimi i erozionit është i lidhur direkt me përmirësimin e kushteve të mjedisit dhe në afatgjatë ndikon drejtëpërdrejtë cilësinë e jetesës. Nje nga detyrat me te rendesishme , por edhe me te veshtira per mbrojtjen e tokave eshte lufta kunder erozionit , nga i cili cdo vit demtohen mijera ha toke bujqesore. Dihet se intensiteti i erozionit varet nga faktoret fiziko-gjeografike si perberja litologjike , relievi (kryesht pjerrësia e tij), kushtet klimatike , shkalla e mbuleses me bimesi dhe tipi i saj dhe nga veprimtaria prodhuese e njeriut.

Kjo zone nuk ka predispozim te theksuar per erozion ne siperfaqen e tokes, ky fenomen eshte ne nivele te paperfillshme. Per shmangien dhe parandalimin e erozionit te zones ku do instalohet linja e fraksionimit dhe impianti i prodhimit te betonit e asfaltit , rrethinave perreth si dhe per ruajtjen e regjimit te rrymes se ujit te reshjeve dhe parametrave hidrodinamike te saj, ne projekt eshte percaktuar shfrytezimi harmonik dhe i kombinuar ne kohe dhe hapësire i zones ne teresi.

Ne zonen ku do zhvillohet projekti hap pas hapi dhe ne perfundim te aktivitetit, eshte parashikuar sistemimi dhe mbulimi i nje siperfaqeje te konsiderueshme me dhera humusore dhe bimesi te zones.

Kjo siperfaqe e perftuar nga trajtimet e mesiperme, do te jape mundesi per kultivimin e bimeve dhe pemeve te ndryshme, duke krijuar njeheresh kushte per parandalimin e eriozionit dhe permiresimin e pamjes se pergjithshme te zones ku do ushtrohet aktiviteti.

6.2 Masat per emetimet ne ajer

Aktiviteti I linjes se fraksionimit te inerteve dhe impiantit te prodhimit te betonit dhe asfaltit nuk sjell emetime te gazeve ne atmosfere sepse nuk perdore lende djegese gjate zhvillimit te aktivitetit te tij prodhues.

Lenda djegese perdoret vetem nga mjetet e transportit te lendeve te para si dhe produktit perfundimtar. Per mbrojtjen nga gazet e motorreve diezel do te merren keto masa :

- 1- Mjetet motorrike do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore.
- 2- Ato do te jene te pajisura ne marmita me katalizatore per kapjen e gazeve toksike.

Procesi teknologjik ben peshimin e materialit inert per realizimin e markave te ndryshme te betonit. Ne te njejten kohe qe peshohet materiali inert ne peshoren tjeter peshohet çimentoja e cila vjen nga pika e furnizimit me bot. Sillosat jane te mbyllur ne menyre hermetike. Furnizimi behet me tuba gome . Ne linje eshte instaluar filtri i pluhurave te çimentos ne menyre qe pluhuri te mos dale ne atmosfere. Pra i gjithe procesi eshte nje cikël i mbyllur dhe nuk emeton pluhura.

Persa i perket pluhurave qe krijohen gjate procesit te ngarkimit apo shkarkimit te lendeve te para nga ana e shoqerise ne menyre periodike sidomos ne kohe te thate do te behet lagja e territorit me uje per shmangien e pluhurit. Transportuesit jane prej gome te hermetizuar si dhe ne linje do te instalohen filtra per pluhurat ne menyre qe te mos ket emetim te tyre ne atmosfere.

Linja e prodhimit te inerteve me thyerje fraksionim eshte me teknologji moderne.

Te gjitha paisjet jane te hermetizuara dhe pluhurat qe krijohen gjate thyerjes ne shkallen e pare, te dyte te coptimit, siten vibruese etj behet sperkatje me uje ne menyre te here pas hershme.

Perreth linjes do te behet sistemimi i ambjentit per qellim mbrojtjen e peizazhit duke bere mbjelljen e pemeve me gjelberim te perhershëm si dhe me lule dekorative. Nga ana e personelit te shoqerise do te tregohet nje kujdes i vecante per mirembajtjen e tyre.

6.3 Masat per uljen ne minimum te zhurmave

Burim zhurme është çdo makinë, instalim, mjet pune, mjet transporti, proces teknologjik, që lëshon zhurmë. Mbrojtja nga zhurma per zhvillimin e ketij aktiviteti duhet te sigurohet nga vet shoqeria aktiviteti te ciles e gjeneron ate. Masat e mbrojtjes nga zhurma përbëjnë tërësinë e ndërhyrjeve dhe të veprimeve, që merren ndaj burimit të zhurmës, si dhe në vendin e ndikimit të saj negativ, duke e sjellë atë në nivelin kufi.

Masat qe do te merren per minimizimin e zhurmave nga ana e shoqerise jane:

- Makinat e transportit dhe pajisjet gjate fazes se ndertimit do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore, te pajisura ne marmita selenciatore te pakesimit te zhurmave.
- Per te ulur me tej ndikimin nga zhurmat punetoret detyrimisht do te perdorin paisjet e mbrojtjes ne pune “kufje”

6.4 Masat per Shkarkimet ne uje

Sic eshte theksuar edhe me siper ky proces nuk shkarkon ne mjedis uJOR prites ujera te ndotura nga procesi i prodhimit te betonit. Uji perdoret si element perzieres ne beton sipas recepturave te caktuara dhe nuk ka teprica te tij. Ujerrat qe dalin gjate larjes se autobetoniereve dhe reshjeve orientohen permes kanaleve perkatese ne vasken e dekantimit dhe me pas per ne mjedisin uJOR prites.

Ujerrat e ndotura nga pluhurat e krijuara do te depozitohen ne vaskat e ndertuara ne sheshin ne afersi te impianteve ne nivelet me te ulta te saj.

Praktikisht do te ndertohen dy vaska me keto parametra: gjatesi 6 m, gjeresi 3 m dhe thellesi 2 m. Uji i ndotur do te shkarkohet ne nje vaske dhe pasi te mbushet me llumra, ujerrat kalojne ne vasken tjeter. Ujrat largohen nga vaska pasi te jene ngurtesuar masa e ngurte inerte dhe depozitohen ne sheshin e caktuar nga pushteti vendor ose ne sheshin ne nje zone te percaktuar . Vaskat rrethohen me lartesi deri 2 m me rrjet metalike te qendrueshme per tu mbrojtur nga renia e njezve ne to dhe per te menjanuar aksidentet ne pune. Ujerrat e pastra pas vaskave do te riperdoren per lagien e territorit per eleminin e pluhurave.

Ne menyre periodike nga ana e shoqerise do te behet pastrimi i kanaleve orientues si dhe vaskes se dekantimit.

6.5 Masat per Depozitimet ne toke

Sheshi i ndertimit ka shume pak ose aspak vegjetacion. Nuk do te jete nevoja per levizje volumesh te medha dherash, pasi terreni eshte relativisht i sheshte.

Mbetjet e ngurta qe vijne si rezultat i projektit jane dherat qe rezultojne nga germimet e bera per nivelim te territorit per instalimin e linjes se fraksionimit dhe prodhimit te betonit . Keto dhera depozitohen ne nje vend te vecante ne menyre qe te riperdoren per rehabilitimin e zones.

Gjate procesit te funksionimit ky aktivitet nuk gjeneron mbetje te ngurta ne forme sterilesh te demshem per mjedisin, ne impiantin e thyerje fraksionimit nuk ka mbetje te ngurta , fraksionet e inerteve qe dalin prej aty hidhen me masen e duhur ne autobetoniere per procesin e perzierje se betonit. Mbetje te tjera te cilat dalin nga aktiviteti i perditshem i punetoreve do grumbullohen ne kontenier dhe me pas largohen per ne vendin e caktuar nga pushteti lokal i zones konform kerkesave te percaktuara. Persa i perket llumrave te cilat dalin nga pastrimi i vaskave te dekantimit depozitohen ne vendin e vecante te percaktuar nga shoqeria.

6.6 Masat estetike dhe ekologjike

Në projektin e impiantit te fraksionimit te inerteve si dhe te prodhimit te betonit e asfaltit do te merren masat estetike dhe ekologjike te cilat konsistojne ne rregullimin e ambjentit te jashtem me lule dekorative per te krijuar nje ambjent te kenaqshem per syrin e njeriut.

6.7 Masat rehabilituese, në rast ndotje dhe dëmtimi të mjedisit

Masat për rigjenerimin e mjedisit do te konsistojne në:

- a. kryerjen e të gjitha punimeve të domosdoshme momentale rehabilituese, sipas projektit
- b. krijimin e sipërfaqeve me mbjellje.
- c. sistemimin e materialeve dhe të sterileve që vijnë nga kryerja e proceseve te punes, të planifikuara në projektin inxhinierik
- d. mbjelljen e siperfaqeve të gjelberuara e mirëmbajtjen e sipërfaqeve të mbjella, etj.

Rastet aksidentale

Zbatimi i ketij projekti nuk do te sjell rrezikshmeri per aksidente, duke qen se nuk do te kete mbajtje ose perdorim i substancave te rrezikshme. Jane marr masat per parandalimin e tyre, mjetet kontrollohen vazhdimisht per gjendjen teknike te tyre ne menyre qe te mos kemi rrjedhje lubrifikante apo karburant. Shoqeria siguron se do kete nderhyrje te menjehershme nese do te kete ndikime negative ne mjedis.

Rreziqet me pasoja ne mjedisin human dhe ekonomik

- Aksidentet e punonjesve gjate procesit teknik ne objekt.
- Aksidentet si pasoje e rrenies se zjarrit.

Probabiliteti i ndodhjes per secilin nga rastet e me siperm do te varet shume nga masat mbrojtese qe do te parashikohen dhe zbatohen. Zhvillimi i aktivitetit nuk shoqerohet me aksidente te cilat mund te sjellin pasoja te demshme ne mjedis si ndotje te ujerave nga lende te rrezikshme, emetime ne ajer nga gaze helmuese apo kontaminim te tokes.

Sigurimi teknik dhe mbrojtja ne pune

Aktiviteti nuk perdor lende te demshme dhe te rrezikshme si per mjedisin ashtu edhe per punonjesit. Lendet e para qe futen ne proces nuk pesojne ndryshime kimike. Per shmangien e aksidenteve nga pajisjet dhe makinerit tregohet nje kujdes i vecante nga punonjesit per mirembajtjen e gjendjes se tyre teknike si dhe zbatohen me rigorozitet kushtet e sigurimit teknik. Gjithashtu ne menyre periodike punonjesit instruktohen per rreziqet ne pune dhe masat e menytrat per parandalimin e tyre.

Per te krijuar nje ambjent pune optimal dhe funksional shoqeria do te pajise te gjitha punonjesit qe do te punojne ne impiantin e fraksionimit dhe te prodhimit te betonit me uniformat dhe mjetet mbrojtese perkatese.

6.8 Masat ndaj zjarrit

Rreziku ndaj zjarrit eshte prezent ne te gjitha mjediset, zjarri eshte nje djegie qe zhvillohet ne menyre te pakontrolluar ne kohe dhe hapesire , pra eshte nje reaksion kimik ndermjet nje trupi te djegshem dhe nje trupi qe djeg. Per te ulur shkallen e rrezikut ndaj zjarrit dhe sigurimin e mbrojtjen e personave nga ana e shoqerise do te merren masat ndaj mbrojtjes se zjarrit. Hidrantet do te vendosen ne zona te dukshme dhe punonjesit do te instruktohen per perdorimin e tyre ne raste aksidentesh. Punëdhënësi pas vlerësimit të rreziqeve të zjarrit dhe në bazë të planit të emergjencës, i përcakton punëtorët përgjegjës për zbatimin e masave të parandalimit të zjarrit, luftën kundër zjarrit dhe menaxhimit të emergjencave. Detyra e përgjegjësit është, jo vetëm të sigurojë që puna të kryhet në bazë të programit, por edhe që ajo të kryhet në kushte sigurie, duke respektuar masat e vëna në dispozicion nga eprorët, rregullat mbi kujdesin në punë, si dhe duke pretenduar që punëtorët të respektojnë standartet dhe të përdorin, nëse nevojitet, pajisje personale mbrojtëse si dhe të kontrollojnë funksionimin e tyre. Ne raste zjarresh do te behet aktivizim i menjehershëm i stafit dhe mjeteve te fikjes se zjarrit si dhe njoftim i menjehershëm i autoriteteve dhe njesive te specializuara ne rast emergjencash (zjarrfikes, autoambulanca). Rruget hyrese ne impiant do te projektohen ne menyre te tille qe te kete lehtësi per hyrjen e njesive te specializuara ne rastet emergjente.

7- PROGRAMI I MONITORIMIT TE NDIKIMIT TE PROJEKTIT NE MJEDIS

Qellimi i monitorimit mjedisor per veprimtarine e projektit eshte qe te siguroje te dhena nepermjet te cilave te vleresohet ne se operimi i veprimtarise eshte ne perputhje me ligjet dhe standartet mjedisore qe lidhen me te, si dhe per te vleresuar performancën mjedisore te menaxhimit te saj ne kuader te permiresimit te vazhdueshem.

Bazuar ne kuadrin ligjor ekzistues te gjithe aktivitetet te cilet veprojne ne mjedis monitorohen persa i perket ndikimit qe ato kane ne mjedis. Ky monitorim behet ne menyre qe te nxjerrim konkluzione sa me te sakta per te kryer nderhyrjet e nevojshme. Monitorimi do te perqendrohet kryesisht ne:

- Faktoret qe gjenerojne ndikime negative ne mjedis
- Efektet e ketyre ndikimeve
- Zbatimin e masave per zbutjen e tyre

Ne pergatitjen e programit te monitorimit specialistet kane marre ne konsiderate mundesine per te realizuar nje monitorim realist te elementeve me ndikim ne mjedis.

Persa me siper eshte menduar qe te perzgjidhen per tu monitoruar nga vete kompania ata elemente qe realisht mund te indentifikohen, maten, regjistrohen dhe komunikohen ne organet e administrimit te mjedisit.

Me poshte jepen disa indikatore te cilet duhen monitoruar per te vleresuar suksesin dhe matur realizimin e objektiveve mjedisore te projektit. Interpretimi i nje gjendje te caktuar mjedisore duhet bere ne lidhje te ngushte me fazen ne te cilen gjendet zbatimi i projektit.

Duhet kuptuar se nje gjendje e perkeqesuar e mjedisit ne nje faze te caktuar te zbatimit e cila eshte faze tranzitore nuk eshte tregues absolut i realizimit te objektiveve te projektit.

Elementet e monitorimit mjedisor te veprimtarise

- Monitorim i zhurmave

Nr	Elementi I monitoruar	Frekuenca	Shpjegime
1	- Monitorim i gjendjes se mjeteve te punes	Vazhdueshem	Ne menyre periodike behet kontrolli i automjeteve
2	- Monitorimi i ngritjes se pluhurave ne linjen e fraksionimit dhe impiantit te prodhimit te betonit	Vazhdueshem	Lagia e ambientit dhe rrugeve

3	- Monitorim i funksionimit te kanalit perimetrik dhe kontrollit te ujerave te shiut	Vazhdueshem	Pastrohen vazhdimisht ne varesi te mases
4	- Monitorim i zhurmave	Vazhdueshem	Per punonjesit merren masat nga zhurmave si kufje
5	- Monitorim periodik i vaskes dekantuese	Vazhdueshem	Pastrohen vazhdimisht nga mbetjet e ngurta qe dekantojne
6	- Monitorim i te gjitha masave te parashikuara per zbutjen e ndikimeve	Vazhdueshem	Ne menyre periodike kontrollohen nga punonjesit

8- PLANI I MENAXHIMIT TE MBETJEVE

Problemet e gjenerimit te mbetjeve dhe administrimit te tyre jane minimale per aktivitetin te cilin po trajtojme. Mbetjet urbane qe krijohen nga aktiviteti i perditshem i personelit hidhen ne vendin e caktuar per kete qellim dhe me pas do largohen per ne vendin e caktuar.

Per te shmangur dhe menaxhuar sa me mire ndikimet negative ne mjedis te shkaktuara nga elementet e pershkruar me siper, subjekti nepermjet personelit te tij harton dhe zbaton nje plan efikas menaxhimi te ndikimit ne mjedis. Realizimi me sukses i ketij plani sjell nje sere perfitimesh per shoqerine te tilla si: ushtrimi i veprimtarise ne perputhje me ligjet dhe rregulloret, mardhenie te mira me publikun dhe ambjentalistet, shmangia e penaliteteve nga organet e kontrollit te mjedisit etj.

Per te parandaluar efekte negative shoqeria ;

- Do te perzgjedh teknologji plotesisht te kontrolluar dhe moderne me pajtuesmeri mjedisore.
- Zbatim rigoroz i rregullave te sigurimit teknik gjate punes dhe nderprerjes se saj duke zbatuar normat e vendosura per kete qellim kur konstatohet shkelje.
- Perdorimi i mjeteve mbrojtese ne pune
- Ne vendet te dukshme dhe me shkalle te larte rreziku te vendosen parrulla paralajmeruese.
- Tokezimi i te gjitha paisjeve qe punojne me energji elektrike per te shmangur aksidente me pasoja

Nga ana e shoqerise dhe stafit te saj do te kontrollohet:

- Paisja me mjetet e duhura te mbrojtjes nga zjarri (MNZ)
- Sigurimi i te gjitha pajisje te nevojshme per riparim, pastrim dhe nderhyrje ne rast emergjencash.
- Sigurimi i ambalazhuesve te sigurt dhe rezistent per mbetjet (kazan, kova, kosha , qese etj).

Do te kete nderhyrje te menjehershme per riparimin e difekteve dhe avarive teknike, ne raste zjarresh do te behet aktivizim i menjehershem i stafit dhe mjeteve te fikjes se zjarrit si dhe njoftim i menjehershem i autoriteteve dhe njesive te specializuara ne rast emergjencash (zjarrfikes, autoambulanca).

Per te shmangur dhe menaxhuar sa me mire ndikimet negative ne mjedis te shkaktuara nga elementet e pershkruar me siper, subjekti nepermjet personelit te tij harton dhe zbaton nje plan efikas menaxhimi te ndikimit ne mjedis. Ne perpilimin e Planit te Menaxhimit dhe analizimin e tij eshte vrejtur se realizimi me sukses i ketij plani sjell nje sere perfitimesh per shoqerine te tilla si: ushtrimi i veprimtarise ne perputhje me ligjet dhe rregulloret, mardhenie te mira me publikun dhe ambientalistet, shmangia e penaliteteve nga organet e kontrollit te mjedisit etj.

Parimet e zbatueshme te programit te menaxhimit te elementeve me ndikim ne mjedis jane paraqitur me poshte nga ana e stafit drejtues i konsultuar me stafe inxhinerike dhe drejtues te objektit. Detajimi i parandalimit, kontrollit dhe nderhyrjeve te stafit te linjes ne elementet e vecante dhe delikate sipas nje table te kuadrit logjik eshte mjaft domethenes per inisiativen dhe pergjegjesine.

9.KONKLUZIONE

Perfundime

- o Zbatimi i projektit nuk do te kete pasoja negative te mundshme ne mjedisin e zones. Ndikime minimale do te kete vetem ne ndryshimin e peizazhit te siperfaqes ku do te instalohet impianti I fraksionimit dhe prodhimit te betonite asfaltit.
- o Procesi teknologjik thyerje-fraksionimit dhe i prodhimit te betonit e asfaltit nuk shoqerohet me shkarkime të lëngta të rrezikshme. Ujerat që përdoren në linjën e prodhimit te betonit thuajse nuk kanë teprica sepse dozohen ne sasi te percaktuara, sasite minimale shkarkohen vetem pas dekanitimit te mases se ngurte ne vasken dekantuese. Meqenëse lendet e para te përdorura për prodhimin e betonit jane inerte, këto ujera nuk

kanë elemente që mund të kontaminojnë mjedisin ujor prites, sipërfaqësore, nentokësore apo tokën.

- Perreth perimetrin të objektit do të ndërtohen kanalet drenazhues për ujërat atmosferike në mënyrë që të shmangët fenomeni i erozionit.
- Ky aktivitet nuk përdore lende të rrezikshme për shëndetin e punonjësve si dhe të popullsisë përreth zonës dhe si rrjedhim nuk ndikon negativisht tek ata.
- Ky projekt nuk sjell emetime të gazeve në atmosferë . Gjatë procesit të ngarkim – shkarkimit të materialit në bunkere, behet pluhur i lehtë dhe drejtuesit e shoqërisë do të marrin masa për sperkatjen me ujë të bunkereve, për paisjen e punëtorëve dhe manovratorëve të mjeteve të rënda me mjetet e domosdoshme për mbrojtjen nga pluhuri, si kominoshe pune, kapele mbrojtëse, doreza pune, maska për mbrojtjen nga pluhuri.
- Niveli i zhurmave që vijnë nga automjetet dhe pajisjet e tjera janë brenda normave të lejuara. Nuk përbejnë problem shqetësues për punonjësit dhe as për banorët e zonës përreth që janë në një distancë të konsiderueshme.
- Furnizimi me energji elektrike do të sigurohet nga rrjeti ekzistues që mbulon zonën duke plotësuar të gjitha kushtet teknike.
- Zona ku do zbatohet projekti nuk njihet si zonë e mbrojtuar me vlera arkitektonike dhe kulturore , pra nuk kemi ndryshime apo demtime të saj duke qenë se nuk ekziston në këtë territor.
- Për një punë sa më optimale në impiant zbatohen rregullat e sigurimit teknik dhe punëtorët e manovratorët njihen me këto rregulla në mënyrë periodike nga drejtuesit teknik të firmës.

Materiali u përgatitë nga

STUDIO PROJEKT shpk

Ekspert Mjedisë Ing. Miniere Xhevair DERMISHI

Gjeoinxhinier Ermir DERMISHI

Ing. Mjedisë Arvena FEJZULLAI

Ing. Kimistë Anxhela BULLATI

Ing. Pyjesh Gerti BRAHIMI